



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

---

**Raport Auditimi Performance**  
*“Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara”*



**Dhjetor 2022**

# P Ë R M B A J T J A

• 1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	4
1.1 Konteksti i problemit social	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	5
• 2. SUBJEKTET NËN AUDITIM	5
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.	5
2.2 Baza ligjore dhe kriteret që rregullojnë çështjen nën auditim	7
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit	9
2.4 Pesha në buxhet	10
2.5 Reagimi ( <i>Feedback-u</i> ) i subjektit përgjatë gjithë auditimit	13
• 3. DETAJET E AUDITIMIT	13
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit	13
3.2 Objektivat e auditimit.	14
3.3 Pyetjet e auditimit	15
3.4 Fushëveprimi i auditimit	16
• 4. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT	16
Pyetja kryesore: A kanë qenë efektive, institucionet përgjegjëse në sigurimin e një arsimimi parauniversitar gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara?	16
MESAZHI I AUDITIMIT	16
4.1. A është hartuar dhe siguruar kuadri ligjor e rregullator i nevojshëm për integrimin në arsimin gjithëpërfshirës të nxënësve me aftësi të kufizuara?	16
4.1.1 A janë hartuar dhe siguruar strategji apo plane veprimi kombëtare për integrimin në arsimin gjithëpërfshirës të nxënësve me aftësi të kufizuara?	16
4.1.2. Si ka qenë niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional për implementimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara?	24
4.2. A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare me fonde si në nivel qendror dhe vendor për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e nxënësve me aftësi të kufizuara?	30
4.3. A janë ndërmarrë marra masa për ngritjen dhe funksionimin e strukturave të përshtatshme për aftësimin dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim?	35
4.3.1 A janë marrë masa për trajnimin e mësuesve ekzistues dhe rekrutimin e MN?	35
4.3.2 A janë ndërmarrë masa për plotësimin e nevojave aftësuese nëpërmjet funksionimit të Komisioneve Multidisiplinare, hartimit të programeve edukuese individuale dhe monitorimit të ecurisë së tyre në kuadrin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës e special?	47
• 5. PËRMBLEDHJE	57
• 6. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE	60
• 7. SHTOJCAT	61

## LISTA E SHKURTIMEVE

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>MAS</b>	Ministria e Arsimit dhe Sportit
<b>EUROSAI</b>	European Organization of Supreme Audit Institutions - Organizata Europiane e Institucioneve të Larta të Auditimit
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit –(International Organization of Supreme Audit Institutions)
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit- (International Standards of Supreme Audit Institutions)
<b>KM</b>	Këshilli i Ministrave
<b>3E</b>	Ekonomiciteti, Efienca, Efektiviteti
<b>KA</b>	Kritere Audituese
<b>SK</b>	Strategjia Kombëtare
<b>NJVQV</b>	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
<b>KB</b>	Këshilli Bashkiak
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>PBA</b>	Program Buxhetor Afat Mesëm
<b>AK</b>	Aftësi të Kufizuara
<b>OJF</b>	Organizatë Jofitimprurëse
<b>ZA</b>	Zyra Arsimore
<b>KDF</b>	Konventa për të drejtat e fëmijëve
<b>KDPAK</b>	Konventa për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara
<b>FAK</b>	Fëmijët me aftësi të kufizuara
<b>KNF</b>	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit
<b>DAR</b>	Drejtori Arsimore Rajonale
<b>SHSSH</b>	Shërbimi Social Shtetëror
<b>QV</b>	Qeveri Vendore
<b>DPAP</b>	Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
<b>DRAP</b>	Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar
<b>ZVAP</b>	Zyra vendore e Arsimit
<b>IAP</b>	Institucione Arsimore Parauniversitare
<b>ASCAP</b>	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
<b>APU</b>	Arsim Parauniversitar
<b>KKBDF</b>	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
<b>PEI</b>	Plan Edukimi Individual
<b>ASHDMF</b>	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
<b>AKDF</b>	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>IPSH</b>	Institucionet e përkujdesit shoqëror
<b>OJF</b>	Organizatë jofitimprurëse
<b>GTN</b>	Grupi Teknik Ndërsektorial
<b>KKMDF</b>	Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
<b>QSHA</b>	Qendra e Shërbimeve Arsimore
<b>NJMF</b>	Njësia për mbrojtjen e fëmijëve
<b>NJVV</b>	Njësia për vetëqeverisjen vendore
<b>SKZHI</b>	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>SZHAPU</b>	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
<b>PKVPAK</b>	Plani Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara
<b>DN</b>	Dispozitat Normative
<b>OZHQ</b>	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

# 1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

## 1.1 Konteksti i problemit social

Arsimimi është një e drejtë themelore njerëzore, thelbësore për arritjen e të gjithë të drejtave njerëzore. Në këtë kuadër, ai duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë njerëzit pa dallim. Në



sistemin e arsimit parauniversitar përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara kryhet në shkollat normale dhe në shkollat speciale. Nxënësit me aftësi të kufizuara përkufizohen si individë që kanë për një kohë të gjatë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në arsim, në baza të barabarta me të tjerët. Aftësi e kufizuar (ose handikap) quhet gjendja e personave të cilët kanë një ose më shumë dëmtime ose aftësi të zvogëluar për të bashkëvepruar me mjedisin shoqëror, krahasuar me atë që konsiderohet si normë. Sipas studimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 15% e popullsisë botërore dhe një në dhjetë fëmijë në mbarë botën ka aftësi të kufizuara. Historikisht, jo vetëm në Shqipëri por kudo, personat me aftësi të kufizuara (PAK) për sa i përket arsimimit të tyre, kanë qenë të përjashtuar nga sistemi i arsimit të përgjithshëm dhe janë trajtuar nga arsimi special, duke u vendosur dhe arsimuar në shkolla speciale. Në shumë raste, PAK janë ndarë nga familjet e tyre dhe janë vendosur në institucione rezidenciale afatgjata, ku janë arsimuar pothuajse krejtësisht të izoluar nga bashkëmoshatarët e tyre dhe nga komuniteti. Koncepti i aftësisë së kufizuar ka ndryshuar shumë bazuar në klasifikimin e ri (të aprovuar nga pothuajse të gjitha shtetet që i përkasin UN) ICF (*International Classification of Functionality*), që identifikon vështirësitë e funksionimit të personit si në nivelin personal ashtu edhe në pjesëmarrjen shoqërore. Në këtë klasifikim, nuk konsiderohen vetëm faktorët biomjekësor dhe patologjikë, por merret në konsideratë edhe ndërveprimi shoqëror gjithashtu. Në këtë mënyrë qasja ndaj PAK bëhet multi-perspektive: biologjike, personale, sociale. Në Republikën e Shqipërisë (RSh) arsimimi i personave me aftësi të kufizuara ka filluar me strukturimin e arsimit special dhe është formalizuar me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 160, datë 29.04.1963 për hapjen në Tiranë të “Institutit për mësimin dhe edukimin e fëmijëve shurdhmemecë dhe të verbër”. Në vitet pasuese, në qytete të ndryshme të vendit janë hapur sipas nevojës disa shkolla të arsimit special ku janë arsimuar dhe trajtuar persona të moshës shkolllore (7-16 vjeç) me lloje të ndryshme paaftësie dhe diagnoze. Niveli arsimor në arsimin special **ka qenë arsimi bazë**, i përshtatur për shkolla speciale të veçanta me plane dhe programe mësimore të veçanta të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Aktualisht funksionojnë 10 shkolla të specializuara (përfshi edhe institutet e fëmijëve që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë) në Tiranë, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Fier, Berat, Durrës dhe Lezhë (shkollë 9-vjeçare private në Pllanë). Nxënësit në shkolla të specializuara trajtohen dhe arsimohen me shpenzimet e shtetit. MAS është përgjegjëse për monitorimin dhe evidentimin e arritjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Të dhënat që mblidhen nga shkollat në DRAP/ZVAP dhe pastaj në MAS, duhen të detajuara, sipas moshës, gjinisë, klasës, llojit të aftësisë së kufizuar, vendbanimit dhe prejardhjes me qëllim përpunimin e tyre dhe daljen në konkluzione për të hartuar dhe përmirësuar politika që synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor. E drejta për arsim për të gjithë fëmijët në Shqipëri, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, është e garantuar nga një shumëllojshmëri ligjesh dhe rregulloresh, si dhe nga objektivat sociale të përcaktuara në kushtetutë. Ligji për arsimin parauniversitar përcakton parime që udhëzojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, konkretisht për zhvillimin e potencialit të tyre fizik dhe intelektual, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurimin e integritetit të tyre të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. Ministria e Arsimit dhe Sportit,

regjistron dhe monitoron fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. MAS në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, prindërit dhe zyrtarët vendore të arsimit parauniversitar, duhet të sigurojnë që çdo fëmijë të regjistrohet në një shkollë të përgjithshme apo speciale. Shteti duhet të sigurojë një arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët duke mbështetur arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara me mësues ndihmës dhe psikolog, me programe mësimore në shërbim të arsimimit të tyre.

## **1.2 Rëndësia e auditimit të performancës**

Ky auditim, ka rëndësi në zbatimin e programeve qeveritare, për rritjen, zhvillimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke vënë theksin tek procedurat dhe mekanizmat kryesore që identifikojnë dhe zhvillojnë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave strategjik në respektimin e të drejtave të tyre dhe ndërgjegjësimin e prindërve.

Auditimi në vetvete është një instrument thelbësor i procesit të llogaridhënies, për shpenzimin e parave publike, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm për miradministrimin e burimeve dhe kryerjen e shërbimeve për qytetarët. Ndërsa nëpërmjet auditimit të performancës Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI Udhëzuesi i Auditimit të Performancës, Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës.<sup>1</sup>

## **2. SUBJEKTET NËN AUDITIM**

### **2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.**

Në Republikën e Shqipërisë sistemi arsimor është gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë, të nxënies gjatë gjithë jetës, duke mundësuar kështu, formimin cilësor, rritjen e mirëqenies të çdo individi, ngushtimin e hendekut të arritjeve arsimore midis grupeve të ndryshme sociale për t'u përballur në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Gjithë përfshirja në arsim është pjesë përbërëse e OZHQ 4-ës dhe nënkupton krijimin e kushteve që të gjithë djemtë dhe vajzat, pavarësisht aftësive dhe karakteristikave të tjera, të vijojnë mësimet bashkë, duke u kujdesur për nevojat individuale të tyre, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme, si dhe të pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga grupet vulnerabël. MAS, në vitin 2016, miratoi dokumentin "Edukimi dhe formimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen – Profili i mësuesit gjithëpërfshirës" me qëllim evidentimin e aftësive thelbësore, dijeve, qëndrimeve dhe vlerave që duhet të ketë gjithsecili mësues, si ai që përgatitet t'i bashkohet radhëve të profesionit të mësuesisë, ashtu dhe ai që është në shërbim, si profesionist gjithëpërfshirës.<sup>2</sup>

Interesi i nxëniesit duhet të jetë parësor përgjatë veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare. Përmbushja e standardeve gjithëpërfshirëse realizohet në shkolla nëpërmjet përmirësimit të reformave kurrikulare, vlerësimeve e pajisjeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, në përmbushje të Rekomandimeve të Këshillit të Evropës për kompetencat themelore për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

<sup>1</sup> Manuali i Auditimit të Performancës.

<sup>2</sup> Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

- **Ministria e Arsimit dhe Sporteve;**
- **Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar;**
- **Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar;**
- **Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar;**

➤ **Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)** ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor, zhvillimin perspektiv të arsimit, respektimin e interesave të individit, komunitetit e të shoqërisë dhe pajisjen me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me kërkesat e ekonomisë së tregut, në përputhje me përparësitë kombëtare dhe evropiane, krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies e të shërbimeve. Ministria ushtron veprimtarinë e saj vetëm ose në bashkëpunim me ministri të tjera, sipas delegimit që i bën Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

Referuar VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, u miratua vendimi për ngritjen e një strukture të re arsimore– Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) – dhe riorganizimin e dy institucioneve IZHA dhe ISHA, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP). DPAP<sup>3</sup> është njësi zbatuese e MAS për arsimin parauniversitar, e cila ka 4 Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), në Lezhë, Durrës, Korçë dhe Fier, si dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) në 61 bashki.

➤ **Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP)** është person juridik, publik buxhetor, financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme dhe është në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu është përgjegjëse për menaxhimin, monitorimin, vlerësimin dhe inspektimin, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore; planifikimin e buxhetit të shkollave; zbatimin e kurrikulës dhe standardeve; ofrimin e asistencës teknike në shkolla, punësimin e mësuesve dhe bashkërendimin me autoritetet vendore të sistemit të arsimit parauniversitar.

DPAP-ja është e organizuar në:

- ✓ nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
- ✓ nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar;
- ✓ njësite e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe Institucionet Arsimore Parauniversitare të sistemit parauniversitar publik.

➤ **Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP)** është pjesë integrale e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve arsimore në juridiksion të tyre, duke siguruar realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim cilësor në arsim.

DRAP-ja organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 668, datë 05.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar”.<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> <http://arsimiparauniversitar.gov.al/>



➤ **Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP)**, janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore në juridiksion të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel vendor. ZVAP organizohet në zbatim të Urdhrit të Ministrit të MAS Nr. 234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”.

➤ **Agjencia e Sigurimi të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)** është institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe ka si qëllim kryesor që të garantojë performancën dhe cilësinë e sistemit të arsimit parauniversitar, në përputhje me qasjen e kurrikulës së bazuar në zhvillimin e kompetencave.

Organizimi dhe funksionimi i ASCAP-it mbështetet në VKM-në Nr. 98, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)” dhe në urdhrin e Kryeministrit Nr. 69, datë 05.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”.

Fushat kryesore të përgjegjësisë së ASCAP-it janë:

- të sigurojë zhvillimin e kurrikulës në arsimin parauniversitar;
- të organizojë zhvillimin profesional dhe kualifikimin e punonjësve arsimorë;
- të monitorojë sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe programet e tyre mësimore.

➤ **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, ka si mision, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta<sup>4</sup>.

Kjo ministri, është përgjegjëse për çështjet sociale, organizon dhe administron sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me kërkesat dhe standardet e ofrimit të tyre<sup>5</sup>.

## 2.2 Baza ligjore dhe kriteret që rregullojnë çështjen nën auditim

Baza ligjore kryesore që rregullon aktivitetin e subjektit lidhur me çështjen nën auditim që do të jetë burimi i kriterëve të auditimit.

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, sanksionon në nenin 18 të saj se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja

<sup>4</sup> <https://shendetesia.gov.al/misioni-2/>

<sup>5</sup> Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 31, paragrafi 1.

ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ka sanksionuar se, kushdo ka të drejtën për arsimim, arsimit shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj, arsimit mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë dhe arsimit mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.


**Konventa OKB-së Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**, ratifikuar me ligjin Nr.7842, datë 03.12.2012 i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuara, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t'u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

**VKM Nr. 659, datë 3.11.2021** është miratuar “Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 (AKDF)”.

- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
- Konventa Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPK)
- Ligji Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Nr.56/215 dhe Nr.48/2018.
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,
- Ligji Nr.139/ 2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar;
- Vendim Nr. 11 datë 11.1.2016 “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për Periudhën 2014 – 2020”.
- VKM Nr.621 datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit parauniversitar 2021-2026”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 659, datë 03.11.2021, Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.
- Vendim Nr.561, datë 29.9.2018 "Për Pajisjen me Tekste Shkollore të Nxënësve, Formimin Fillestar, Zhvillimin e Mëtejshëm Profesional të Mësuesve, si dhe Krijimin e Funkcionimit të Klasave në Gjuhën e Pakicave Kombëtare
- Vendim Nr. 708, datë 26.8.2015, “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”.
- Plani Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016 – 2020,
- Vendim Nr. 276, datë 12.05.2021 Plani Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021 – 2026.
- Raporte vjetore monitorimi<sup>6</sup>;
- Raporte nga organizata ndërkombëtare;<sup>7</sup>
- PBA për çdo ministri.
- Plani Kombëtar për personat me aftësi të kufizuara 2021-2025 miratuar me VKM Nr.276 datë 12.05.2021.
- Strategjia Evropiane për aftësinë e Kufizuar 2021-2030.
- Konventa e OKB-së për të drejtat e PAK
- Ligji Nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019” miratimi fondit për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë për vitin 2019

<sup>6</sup>Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Identifikimi i nevojave për zhvillim profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar, 2021. Etj.

<sup>7</sup><http://datAuis.unesco.org/>

- Akti normativ Nr.2, si dhe akti normativ Nr.3, dhjetor 2019 fondet e buxhetit të rishikuar.
- Ligji Nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë miratimi fondit për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë për vitin 2020.
- Akti normativ Nr. 6, datë 21.03.2020 si dhe akti normativ Nr.15, datë 15.04.2020 fondet e buxhetit të rishikuar.
- Ligji Nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”
- Manuali për mësuesit ndihmës.
- VKM Nr.98, datë 27.02. 20219 “Për organizimin e ASCAP “
- VKM Nr.99, datë 27.02.2019 “ për organizimin e DPAP
- VKM Nr. 140, datë 18.2.2015 “Për miratimin e rregullores për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të arsimit parauniversitar”.
- VKM Nr.380, datë 05.06.2019 “Për miratimin e dokumentit politik reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019-2024 për zbatimin e tij.
- Udhëzim Nr.26, datë 25.11.2019 “Për mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”
- Urdhër Nr.68, datë 05.04.2019 Për miratimin e Strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të arsimit parauniversitar”
- Urdhër Nr.69, datë 05.04.2019 Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Sigurimit të cilësisë së Arsimit Parauniversitar.
- Urdhër Nr.234, datë 19.04.2019 Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave vendore të arsimit parauniversitar ndryshuar me urdhrin Nr.176, datë 01.07.2020.
- Urdhër i Ministrisë të Arsimit Nr.593, datë 31.12.019 për disa ndryshime në urdhrin Nr.344, datë 19.08.2013 Për ngritjen e njësisë së shërbimit psikosocial.
- VKM Nr.353, datë 12.6.2018, “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njërive administrative”;
- VKM Nr. 148, datë 13.3.2018, “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit midis mekanizmave institucionalë, strukturave për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor dhe organizatave jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare dhe vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve”;
- Udhëzim Nr. 394, datë 9.5.2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të perkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare”;
- Udhëzim nr. 38 datë 07.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar”;
-  Akte të tjera ligjore dhe nën ligjore në funksion të auditimit.

### **2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit**

Institucionet e përzgjedhura si objekt auditimi janë të lidhura drejtpërdrejtë me politikbërjen dhe ofrimin e shërbimeve për realizimin e mekanizmave të parashikuar për zhvillimin e një sistemi arsimorë cilësorë dhe gjithëpërfshirës bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE. Konkretisht:

Produktet e subjektit nën auditim lidhen me qëllimin final garantimin e një arsimit gjithëpërfshirës që ka për bazë nevojat dhe interesat e nxënësve; që krijon kushtet dhe mundësitë për studentët për të ndërtuar dhe zhvilluar njohuritë e tyre, aftësitë dhe vlerat e kërkuara nga shoqëria; që lejon nxënësit të zhvillohen si dhe për të kontribuar për mirëqenien e tyre dhe të shoqërisë dhe në mënyrë konstruktive të përballen me sfidat e jetës nëpërmjet politikave masave dhe mekanizmave si:

- Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitje e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit dhe formimit;
- Nxitja e barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive;
- Edukimi publik në funksion të ndërgjegjësimit të shoqërisë për pranimin dhe trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Përmirësimi i cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës dhe forcimi i kapaciteteve të mësimdhënies për fëmijët me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara që përfshijnë futjen e komisioneve Multidisiplinare të arsimit, futjen e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara që studiojnë në shkolla të zakonshme dhe përgatitjen e materialit të ri didaktik.
- Shkëmbimi reciprok i informacionit për fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollore, për të realizuar vlerësimin e drejtë të aftësive për kryerjen e veprimtarive bazë të jetës, në përputhje me grup-moshat, si edhe për të siguruar identifikimin dhe plotësimin e nevojave aftësuese të këtyre fëmijëve në kuadrin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës e special.
- zhvillimi profesional i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, etj.

Të gjitha këto masa apo veprime, duhet të mbështeten në plane veprimi konkrete, të cilat përbëjnë bazën e proceseve me synim ngritjen e një sistemi mbështetjeje eficient, në ndihmë të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe familjeve të tyre. Duke synuar përmirësimin dhe zbatimin e strategjive të mësimdhënies apo mësim nxënies. MAS dhe institucionet e saj të varësisë si dhe MSHMS lidhur me temën dhe fokusin e auditimit kanë gjeneruar produkte politike si strategjia për arsimin universitar 2021 -2026, plani i veprimit 2021-2025 udhëzime, statistika, trajnime të mësuesve ndihmës, raporte monitorimi, aktivitete që adresojnë fokusin tonë të auditimit, etj. Grupi i auditimit bazuar mbi këto produkte do të evidentojë problematikat dhe realizojë auditimin.


## 2.4 Pesha në buxhet

**Tabela nr.1, Shpenzimet për arsimin parauniversitar në rang vendi ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Shpenzimeve Publike.**

*000 lekë*

Nr.	Kategoria e shpenzimeve	2019	2020	2021
1	Buxheti i MAS-së për arsimin	39,923,715	39,235,038	41,906,020
2	Fonde të tjera për arsimin nga institucione të ndryshme	4,476,000	4,319,000	4,396,000
3	Fonde për arsimin të NJQV-ve	8,237,231	7,617,629	<b>15,646,029</b>
4	Të ardhurat të tj. Pub. për arsim, ndihma donac., grante, etj.	3,047,986	2,986,334	<b>2,332,951</b>
<b>5</b>	<b>Gjithsej fonde për arsimin (1+2+3+4)</b>	<b>55,684,932</b>	<b>54,158,000</b>	<b>64,281,000</b>
6	Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)	<b>1,691,727,000</b>	<b>1,617,541,000</b>	<b>1,769,258,000</b>
7	Shpenzime për arsimin në % ndaj PBB-së (5/6)	3.3	3.3	3.6
<b>8</b>	<b>Gjithsej, shpenzimet publike</b>	<b>491,897,000</b>	<b>536,279,000</b>	<b>610,199,000</b>
9	Shpenzime për arsimin në % ndaj shpenz. publike 5/8)	11.3	10.1	10.5

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit- Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së  
Grafiku Nr.1. Fondet për arsimin ndaj PBB (2019 -2021)



Nga te dhënat e paraqitur në tabelën dhe grafikun e mësipërm tregohet qartë se:

- Shpenzimet për arsimin në rang vendi për vitin 2019 janë **55,684,932 mijë** lekë dhe zënë rreth 3.3% kundrejt PBB dhe 11.3% kundrejt shpenzimeve publike;
- Shpenzimet për arsimin në rang vendi për vitin 2020 janë **54,158,000 mijë** lekë dhe zënë rreth 3.3% kundrejt PBB dhe 10.1 % kundrejt shpenzimeve publike;
- Shpenzimet për arsimin në rang vendi për vitin 2021 janë **64,281,000 mijë** lekë dhe zënë rreth 3.6% kundrejt PBB dhe 10.5% kundrejt shpenzimeve publike;


**Tabela nr. 2** Shpenzimet për arsimin parauniversitar në rang vendi për fëmijët me Aftësi të Kufizuar.

Në lekë

Nr.	Kategoria e shpenzimeve	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Instituti fëmijët nuk shikojnë/ Dëgjojnë	88,801,298	81,620,365	88,645,421
2	Fonde për Bursat akorduar NJQV për FAK	30,094,753	24,196,813	97,420,451
3	Fonde për Tekstet shkollore për FAK	28,080,000	29,160,000	30,240,000
4	Fonde për Transporti për FAK	43,750,000	43,750,000	43,750,000
5	<b>Pagat e mësuesve ndihmës</b>	579,580,747	676,177,538	772,774,330
6	<b>Pagat e punonjësve psiko-sociale</b>	283,055,850	323,492,400	363,928,950
	<b>Totali</b>	<b>1,053,362,648</b>	<b>1,178,397,116</b>	<b>1,396,759,152</b>

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit  
Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Grafiku nr.2.** shpenzimet për arsimin në % PBB dhe shpenzimeve publike



**Tabela nr.3** Shpenzimet për arsimin në rang vendi, për fëmijët me Aftësi të Kufizuar, në % ndaj: shpenzimeve për arsimin parauniversitar, Prodhimi i Brendshëm Bruto dhe Shpenzimeve Publike


000 lekë

Nr.	Kategoria e shpenzimeve	2019	2020	2021
1	Buxheti i MAS-së, vetëm për arsimin parauniversitar	<b>33,360,166</b>	<b>33,382,350</b>	<b>33,811,686</b>
2	Fonde për arsimin parauniversitar, vetëm për FAK	<b>1,053,363</b>	<b>1,137,961</b>	<b>1,315,886</b>

3	Fonde për arsim parauniversitar për FAK të NJQV-ve	0	0	0
4	Të ardhurat të tjera për arsimin parauniversitar të FAK nga ndihma, donacione, grante, etj.	0	0	0
5	Totali i fondeve për arsim parauniversitar për FAK (2+3+4)	<b>1,053,363</b>	<b>1,137,961</b>	<b>1,315,886</b>
6	<b>Gjithsej fonde për arsimin parauniversitar (1+5)</b>	<b>34,413,529</b>	<b>34,520,311</b>	<b>35,127,572</b>
7	Shpenzime për arsimin për FAK në % ndaj shpenzimeve për arsimin parauniversitar (5/1)	3.2	3.5	4.1
8	<b>Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)</b>	<b>1,691,727,000</b>	<b>1,617,541,000</b>	<b>1,769,258,000</b>
9	Shpenzime për arsimin për FAK në % ndaj PBB-së (5/8)	0.06	0.07	0.08
10	<b>Gjithsej shpenzimet publike në rang vendi</b>	<b>491,897,000</b>	<b>536,279,000</b>	<b>610,199,000</b>
11	Shpenzime për arsimin e FAK në % ndaj shpenzimeve publike (5/11)	0.21	0.22	0.23


Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit  
Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Grafiku Nr.3, shpenzimet për arsimin parauniversitar në rang vendi për fëmijët me aftësi të




kufizuar

Grafiku Nr.4, shpenzimet për arsimin parauniversitar në rang vendi sipas viteve, për fëmijët me Aftësi të Kufizuar



Grafiku nr5, shpenzimet për arsimin në rangë vendi, për fëmijët me Aftësi të Kufizuar, në % ndaj: shpenzimeve për arsimin parauniversitar, PBB dhe shpenzimeve publike



Nga të dhënat në tabelat 2 dhe 3 dhe në grafikët respektive të mësipërme e tregohet se:

- Shpenzimet për arsimin parauniversitar në rang vendi, vetëm për fëmijët me Aftësi të Kufizuar për vitin 2019 janë në vlerën **1,053,363 mijë** lekë dhe zënë: rreth 3.2 % kundrejt shpenzimeve për arsimin parauniversitar, rreth 0.06% kundrejt PBP dhe 0.21% kundrejt shpenzimeve publike në rangë vendi;
- Shpenzimet për arsimin parauniversitar në rang vendi, vetëm për fëmijët me Aftësi të Kufizuar për vitin 2020 janë në vlerën **1,137,961 mijë** lekë dhe zënë: rreth 3.5 % kundrejt shpenzimeve për arsimin parauniversitar, rreth 0.07% kundrejt PBP dhe 0.22 % kundrejt shpenzimeve publike në rangë vendi;
- Shpenzimet për arsimin parauniversitar në rang vendi, vetëm për fëmijët me Aftësi të Kufizuar për vitin 2020 janë në vlerën **1,315,886 mijë** lekë dhe zënë: rreth 4.1 % kundrejt shpenzimeve për arsimin parauniversitar, rreth 0.08 % kundrejt PBP dhe 0.23% kundrejt shpenzimeve publike në rangë vendi;

## 2.5 Reagimi (Feedback-u) i subjektit përgjatë gjithë auditimit

Gjatë fazës studimore dhe asaj të terrenit, stafet përgjegjëse të subjekteve objekt auditimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e tyre në varësi janë treguar të gatshëm në komunikime për trajtimin e çështjeve të ndryshme që grupi i auditimit vendosi t'i trajtonte.

Në përgjithësi, subjektet e mësipërme i janë përgjigjur në kohë takimeve konsultuese dhe intervistave të realizuara, por përgjigjet e pyetësorëve drejtuar MSHMS, MAS, DPAP, DRAP-ve dhe ZVA-ve janë vonuar shumë dhe nuk kanë qenë të plota, fakt i cili ndikoi në realizimin e auditimit. Plotësimi i informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi subjektet, kërkuar më shumë kohë në përgjigjet e tyre kjo edhe për shkak të faktit se nën një DRAP janë përgjithësisht mbi shtatëmbëdhjetë ZVA në varësi të cilat duhet të raportonin.

Informacioni i kërkuar, është vënë në dispozicion përgjithësisht në format elektronik por, jo i shoqëruar gjithmonë edhe me dokumentet përkatëse.

Gjithashtu, problem ka qenë edhe interneti dhe aksesimi në e-maillet zyrtare për shkak të sulmeve kibernetike që ndodhën në muajin Korrik të këtij viti.

## 3. DETAJET E AUDITIMIT

### 3.1 Vlerësimi i risqeve të aktivitetëve të subjektit

Risqet e aktivitetit të subjektit nën auditim janë ato me të cilat përballen aktorët e përfshirë në arritjen e objektivave dhe realizimin e detyrave e funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, për realizimin e përgjegjësisë që krijohen nga aktiviteti në tërësi duke u fokusuar në politikat, programet, proceset dhe strategjitë që ndjekin këto institucione për zhvillimin e

arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës për FAK. Risqet e aktiviteteve të subjektit mbartin me vete disa problematika, ku më kryesoret janë hartimi dhe zbatimi i politikave, strategjive nga institucionet përgjegjëse, ngritja dhe zhvillimi i strukturave implementuese dhe monitoruese, ndërveprimi institucional, parashikimi i instrumenteve financiare.

Risqet e aktiviteteve të subjektit nën auditim kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që institucioni has në arritjen e objektivave dhe realizimin e detyrave e funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Në këtë auditim, analiza e riskut është mbështetur në identifikimin e risqeve sipas elementëve të analizës si më poshtë:

**Tabela Nr.4**

Op/Str	Përshkrimi i Riskut	Niveli i Riskut	Pyetja e Auditimit	Efektet që mund të kenë risqet e identifikuar	Realizueshmëria
Strategjik	Mungesa e politika dhe akte ligjore të plota dhe bashkëkohore. Mungesa e Planeve të punës. Mungesa e përcaktimit të objektivave për realizimin e për plotësimin e nevojave aftësuese të FAK në kuadrin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës e special.	L	A kanë qenë efektive institucionet përgjegjëse në sigurimin e një arsimiti parauniversitar gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara?	Mos detajimi i detyrimeve të përcaktuara në strategji apo mos hartimi i politikave të duhura ndikon në menaxhim jo të mirë për përfitimin e modeleve të zhvillimit për FAK me ndikim social e ekonomik.	Vështirë
Operacionale	Mund të mos jetë siguruar implementimin e politikave dhe strategjive që synojnë zhvillimin e FAK	L	A është hartuar dhe siguruar kuadri ligjor e rregullator i nevojshëm për integrimin në arsimin gjithëpërfshirës të nxënësve me aftësi të kufizuara?	Mos bashkëpunimi/koordinimi i strukturave përgjegjëse, mungesa në mjete logjistike dhe burime njerëzore Mungesa e mbështetjes financiare nga buxheti i ministrive të përfshira në program do të bënte të vështirë ose të pamundur arritjen e objektivave të përcaktuara në strategji dhe si rezultati nuk do të sigurohej aksesueshmëria e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin gjithëpërfshirës.	Vështirë
	Mund të mos jetë siguruar mbështetja financiare për implementimin e politikave dhe strategjive që synojnë zhvillimin e FAK	L	A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare me fonde si në nivel qendror dhe vendor për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e nxënësve me aftësi të kufizuara?	Mungesa e mbështetjes financiare do të bënte të vështirë ose të pamundur arritjen e objektivave të përcaktuara në strategji	Vështirë
	Procesi i ndjekur për të siguruar kushte të përshtatshme për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara mund të mos jetë efektiv.	L	A janë ndërmarrë marra masa për ngritjen dhe funksionimin e strukturave të përshtatshme për aftësimin dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim?	Ndikon në mirë menaxhimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor parauniversitar	Vështirë

### 3.2 Objektivat e auditimit.

Objektivi kryesor i auditimit është vlerësimi mbi efektivitetin e zbatimit dhe implementimit të politikave ligjore dhe rregullatore nga institucionet nën auditim, për arsimin special dhe gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Për të përmbushur objektivin kryesor grupi i auditimit vlerësoi:

- *Kuadrin ligjor që rregullon çështjet nën auditim, nëse ai është i plotë, i përditësuar dhe nëse zbatohet me rigorozitet nga strukturat përgjegjëse;*
- *Organizimin e duhur strukturor (nëse janë ngritur dhe funksionojnë strukturat përgjegjëse);*

▪ *Bashkëveprimin dhe koordinimin ndërinstitucional midis aktorëve përgjegjës dhe monitorimin e realizimit të indikatorëve me qëllim rritjen e aksesit në arsimin gjithëpërfshirës;*

▪ *Mekanizmat mbështetës dhe aksesueshmërinë infrastrukturore për realizimin e objektivave strategjik dhe ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit.*

Grupi i auditimit nëpërmjet analizës së veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse dhe vlerësimit të fushave të sipërcituara, u përpoq të evidentonte problematikat që kanë ndikuar dhe shoqëruar arsimimin e fëmijëve me AK, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime për përmirësime të mëtejshme.

### 3.3 Pyetjet e auditimit

Skema Nr.2 Piramida e pyetjeve të auditimi



### 3.4 Fushëveprimi i auditimit

Tema e fëmijëve me aftësi të kufizuara është e një game shumë të gjerë, sepse përfshihen dhe ndërthuren shume institucione të cilat kanë objekt veprimtarie dhe specifika të ndryshme nga njëra tjetra si në nivel qendror dhe vendor. Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim dhe ka patur në fokus arsimimin e fëmijëve me AK, pasi numri i këtyre fëmijëve vitet e fundit është gjithmonë e më shumë në rritje. Auditimi u fokusua mbi nivelin e politikave të hartuara dhe efektivitetin e zbatimit të tyre për sa i përket fazës së identifikimit të FAK në shkolla, trajtimin me programe individuale zhvillimi, monitorimit të ecurisë së progresit të të nxënësve dhe efektivitetit të strukturave të përfshira në proces. Në këtë këndvështrim, auditimi u përqëndrua në vlerësimin e masave të marra nga aktorët përgjegjës për identifikimin e problematikave kryesore që lidhen me fazën e identifikimit dhe implementimit të mekanizmave për zhvillimin e FAK në arsimin parauniversitar (*ku përgjithësisht do të përfshihet grup mosha 6-17 vjeç*), zbatimin e dokumenteve politike dhe strategjike që i shërbejnë këtij qëllimi si dhe specializimit dhe zhvillimit profesional të strukturave të përfshira në proces. Për të vlerësuar performancën e efektivitetit të politikave dhe institucioneve përgjegjëse për garantimin e një shërbimi arsimor cilësor, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e nxënësve me AK, në mënyrë që të përballojnë sfidat e së ardhmes, referuar analizimit të të dhënave, medias së shkruar, raporteve të OJF-ve auditimi do të shtrihet në institucionet si më poshtë:

- **Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë dhe pjesërisht në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;**

Gjatë fazës së kryerjes së auditimit grupi i auditimit kreu vizita dhe verifikime në terren, edhe në subjektet nën menaxhimin e DRAP Durrës, Lezhë, Fier, Korçë. Periudha që do të auditohet është 01.01.2019 deri më 30.06.2022.

## 4. SHTJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

**Pyetja kryesore: A kanë qenë efektive, institucionet përgjegjëse në sigurimin e një arsimiti parauniversitar gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara<sup>8</sup>?**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivit në fazën studimore, intervistave dhe pyetësorëve me përfaqësuesit e subjektit, si dhe analizimit dhe testimin të evidencave përgjatë fazës analitike, Grupi i Auditimit arriti në këtë mesazh:

### MESAZHI I AUDITIMIT

*Rritja e bashkëveprimit dhe koordinimit të institucioneve arsimore, për arsimim si e drejtë themelore njerëzore, është thelbësore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fuqizimin e sistemit të gjithëpërfshirës dhe monitorimin e tij, përmirësimin e infrastrukturës dhe procesit të mësim nxënies, evidentim e vlerave, dijeve dhe aftësive që duhet të ketë gjithsecili, ndërgjegjësimin e prindërve dhe komunitetit me qëllim zhvillimin e plotë të konceptit të gjithëpërfshirës, integrimin e këtyre fëmijëve në jetën shoqërore dhe aftësimin për përfshirjen në tregun e punës.*

**4.1. A është hartuar dhe siguruar kuadri ligjor e rregullator i nevojshëm për integrimin në arsimin gjithëpërfshirës të nxënësve me aftësi të kufizuara?**

**4.1.1 A janë hartuar dhe siguruar strategji apo plane veprimi kombëtare për integrimin në arsimin gjithëpërfshirës të nxënësve me aftësi të kufizuara?**

<sup>8</sup> Terminologjia e përdorur në lidhje me temën e auditimit i është përmbajtur bazës ligjore të fushës që do të auditohet, e cila buron nga Konventa e OKB-së Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit ka avancuar dukshëm në dekadën e fundit. Këtë arritje e njih edhe raporti i BE-së, i vitit 2020, i cili vlerëson, se nisur nga perspektiva e legjislacionit arsimor, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë në tërësi për anëtarësim në BE. Këtë legjislacion e përbëjnë katër ligje kryesore:

- Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, i ndryshuar;

si dhe disa ligje të tjera të ndërlidhura me administrimin e sistemit të arsimit.

Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, u ndryshua në vitin 2015 dhe në vitin 2018, si dhe u miratuan një sërë aktesh nënligjore në zbatim të tij, duke përfshirë vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), urdhra dhe udhëzime të ministrit.

Ndryshimet legjislative ishin kryesisht në funksion të përmbushjes së objektivave të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014–2020, duke krijuar kushte për zbatimin e reformave të rëndësishme si: kurrikula e bazuar në kompetenca, rekrutimi transparent dhe i bazuar në meritë i mësuesve, struktura e re qeverisëse e sistemit të arsimit parauniversitar, si dhe përmirësimi i shërbimit në arsim për qytetarët.

**Neni 24** i Konventës së Kombeve të Bashkuara, mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe protokollin opsional, adoptuar në vitin 2006, që i kushtohet arsimimit të PAK, ndër të tjera përcakton se shtetet palë duhet të garantojnë:

1. *Lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave dhe nxitjen e identitetit lingvistik të personave që nuk dëgjojnë.*
2. *Që arsimimi i individëve dhe në veçanti i fëmijëve, të cilët janë të verbër, nuk dëgjojnë, apo që nuk dëgjojnë e nuk shikojnë, në të njëjtën kohë të jepet në gjuhën, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në ambiente të cilat rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror të tyre.*
3. *Masat e duhura për punësimin e mësuesve, duke përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuar, të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/apo Braille, dhe të trajtojnë profesionistët dhe stafin që punon në të gjitha nivelet arsimore.*
4. *PAK, të jenë në gjendje të kenë akses në arsimin e lartë, trajnime profesionale, arsimin për të rritur dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës, pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët.*

Në legjislacionin shqiptar për arsimin, deri në vitin 2012, arsimimi i PAK ishte parashikuar të zhvillohej në institucionet e arsimit special dhe në Institucionet Arsimore Parauniversitare publike, sipas kreut III, të ligjit nr.7952, datë 21.06.1995, i cili përcaktonte;

1. *Arsimi special publik është pjesë përbërëse e sistemit arsimor publik në Republikën e Shqipërisë.*
2. *Arsimimi i fëmijëve që paraqesin nevoja të veçanta, kryhet falas në Institucionet Arsimore Parauniversitare publike, nëse kjo është dëshira e prindërve dhe zgjidhja më e drejtë profesionale.*
3. *Për fëmijët, të cilët paraqesin nevoja të veçanta që nuk mund të plotësohen brenda sistemit shkollor, ngrihen klasa dhe institucione të posaçme, ku trajtimi i specializuar bëhet falas.*

Në Dispozitat Normative (DN) 2005 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, përcaktohej: *Arsimimi i nxënësve me aftësi të kufizuara realizohet në dy forma: përmes integritit të tyre në shkollat e arsimit publik (shkollat e zakonshme) në kuadrin e gjithëpërfshirjes dhe*

*nëpërmjet trajtimit të tyre në shkolla apo klasa publike të veçanta (speciale), sipas kategorive e specifikave që ata paraqesin, të cilat janë pjesë e rrjetit të institucioneve shkollore parauniversitar publike të Republikës së Shqipërisë.*

Në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, që u pasua me miratimin e DN 2013, për institucionet e arsimit parauniversitar, në parimet e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara (neni 23), u përcaktua: “Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Institucionet Arsimore Parauniversitare të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është **parësore**”.

“Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitar (RFIA) në Republikën e Shqipërisë”, e miratuar me Urdhrin e MAS, nr. 31, datë 28.01.2020, kreu XIV, i dedikohet arsimimit të nxënësve me AK, duke përcaktuar procesin që fillon me ngritjen dhe funksionimin pranë Zyrate Arsimore Vendore të Komisionit Multidisiplinar për vlerësimin e nevojave arsimore të nxënësve me AK dhe vijon me gjithëpërfshirjen dhe arsimimin e tyre në institucione arsimore. Në këtë rregullore neni 86 dhe 87 i kushtohet shkollave speciale dhe trajtimit të specializuar që ato ofrojnë për fëmijët me AK.

### **Arsimi gjithëpërfshirës:**

- Nënkupton një mjedis të të nxënësve që mundëson akses, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit.
- Nënkupton që shkollat duhet të përshtaten për të gjithë nxënësit, pavarësisht kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore apo kushteve të tjera.
- Është një nga pjesët përbërëse të arsimit cilësor me bazë të drejtat që theksojnë barazinë në akses dhe pjesëmarrje, dhe që i përgjigjet pozitivisht nevojave dhe kompetencave individuale të të nxënësve për të gjithë fëmijët.
- Ka në qendër fëmijën dhe e kalon përgjegjësinë e përshtatjes në sistemin arsimor dhe jo te fëmija si individ.

**Gjithëpërfshirja** në arsim është pjesë përbërëse e OZhQ 4<sup>ës</sup> dhe ka qenë në fokus të politikave arsimore në Shqipëri në dekadën e fundit, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme, si dhe të pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga grupet vulnerabël.

Ligji nr. 69/2012, “Për Arsimin Parauniversitar”, përcakton parimet që orientojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky ligj kërkon arsim falas dhe të detyrueshëm, i cili ndiqet nga fëmijët e moshës 6-16 vjeç. Ligji promovon konceptin e arsimit gjithëpërfshirës, duke specifikuar se përfshirja në institucionet e arsimit gjithëpërfshirës është e përkohshme dhe përfshirja në kopshtet dhe shkollat e zakonshme ka rëndësi të madhe.

Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2021 – 2026, synon të përmirësojë cilësinë e arsimit për të gjithë dhe e përcakton të nxënësve gjithëpërfshirës si objektivi të politikës të MAS. Të nxënësve gjithëpërfshirës në këtë strategji nënkupton një qasje ku të gjithë fëmijët mësojnë së bashku në shkollën më të afërt të rregullt, pa diskriminim racor, gjinor, etnik, mbi aftësinë e kufizuar ose tjetër.


Bazuar në të dhënat e MSHMS/SHS, numri i fëmijëve me AK në sistemin arsimor dhe numri i fëmijëve me AK në total në Shqipëri për vitet 2019 – 6 muajori i parë i vitit 2022, të ndarë sipas grup moshave, gjinisë dhe pjesëmarrjes në arsimim paraqitet sipas të dhënave sa më poshtë vijon:

**Numri i fëmijëve me AK në sistemin arsimor dhe numri i fëmijëve me AK në total në Shqipëri**

AK mesatare sipas viteve	Sipas grup moshave				Nga gjithsej sa janë femra sipas grup moshave				Sistemi arsimor qe ndjekin			
	Gjithsej	Nga këto vjeç:			Gjithsej	Nga këto			Gjithsej	Nga këto		
		0-6 vjeç	6-15 vjeç	15-18		0-6 vjeç	6-15 vjeç	15-18		Para-shkollor	9-vjeçar	I mesëm
2019	15,276	4,315	7,365	3,596	6,882	2,061	3,200	1,621	8,237	1,809	4,864	1,564
2020	15,685	4,494	7,552	3,639	7,252	2,169	3,350	1,734	8,442	1,944	4,974	1,524
2021	15,181	4,181	7,536	3,464	7,017	2,072	3,273	1,672	7,877	1,866	4,667	1,345
2022/6 muajori I	14,558	3,944	7,330	3,284	6,690	2,008	3,092	1,590	7,501	1,822	4,583	1,096
	60,700	16,934	29,783	13,983	27,841	8,310	12,915	6,616	32,057	7,441	19,088	5,529
Mesatare e total	15,175	4,234	7,446	3,496	6,960	2,077	3,229	1,654	8,014	1,860	4,772	1,382

Burimi i të dhënave MSHMS/SHS

Grafiku nr.6, "Numri i fëmijëve me AK në total krahasuar me numri e tyre në sistemin arsimor në Shqipëri.




Burimi i të dhënave MAS

Pjesëmarrja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në moshë shkollore në arsimin parauniversitar është shtuar nga viti në vit. Në veçanti, kjo vlen për shkollat e zakonshme ku numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara është shtuar nga 2,849, në vitin shkollor 2013–2014, në 3.927, në vitin shkollor 2020–2021 (grafiku 2), ku rreth 70% e këtyre fëmijëve ndjekin arsimin bazë, 19% arsimin parashkollor dhe pjesa tjetër arsimin e mesëm të lartë. Ndërkohë, mësimet në shkollat speciale i vijnë 652 fëmijë me aftësi të kufizuara.

Nga 310,338 nxënës në total në shkollat 9 vjeçare dhe arsimin e mesëm publik për vitet 2020 -2021, 3,927 prej tyre janë me aftësi të kufizuara.

Të ndara sipas nivelit të arsimimit nxënës në total në shkollat 9 vjeçare dhe në arsimin e mesëm publik për vitet 2020 -2021, dhe ato me aftësi të kufizuara, paraqiten në grafikun sa më poshtë, nga ku evidentohet se në shkollat e arsimimit të mesëm publik kanë vazhduar 25.7% e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë mbaruar arsimimin 9 - vjeçar.


Grafiku nr.8, “Nxënës me AK në shkolla 9 vjeçare dhe arsimit të mesëm publik për vitet 2020 -2021.



Burimi i të dhënave MAS.

Përsa i përket arsimimit në shkollat jo publike rezulton se numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që mësojnë në to është shumë i ulët (vitet 2020 – 2021). Në total në arsimin publik janë 3,927 fëmijë me aftësi të kufizuara ndërsa në arsimin jo publik janë 78 nxënës me aftësi të kufizuara ose 2% e arsimit publik.

Grafiku nr.9, “Nxënës në total me nxënësit me aftësi të kufizuara në shkolla 9 vjeçare dhe arsimin e mesëm publik për vitet 2020 – 2021”.



Burimi i të dhënave MAS.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve për periudhën objekt auditimi ka miratuar Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 dhe më pas Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026, shoqëruar me planin e veprimit për zbatimin e saj, por ky plan veprimi nuk është shoqëruar me masa konkrete dhe të matshme, dedikuar për fëmijët me aftësi të kufizuar, i cili do të mundësonte dhe do të lehtësonte arritjen e objektivave. Mungesa e një plani veprimi të dedikuar për fëmijët me aftësi të kufizuar, cenon arritjen dhe zbatimin e Zhvillimit të Objektivave të Strategjisë.

#### **Gjetje nga auditimi:**

1. Ministria e Arsimit dhe Sporteve planin e veprimit të Strategjisë Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 dhe Strategjisë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026 nuk e ka shoqëruar me masa konkrete dhe të matshme, dedikuar për fëmijët me aftësi të kufizuar.

#### **Konkluzion:**

1. Hartimi dhe miratimi i planit të veprimeve dedikuar fëmijëve me aftësi të kufizuar, do të mundësonte matjen, monitorimin, ndjekjen dhe raportimin periodik e arritjes dhe zbatimin të Strategjisë Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar për ta, si një qasje ku të gjithë fëmijët mësojnë së bashku në shkollën më të afërt të rregullt, pa diskriminim racor, gjinor, etnik, mbi aftësinë e kufizuar ose tjetër.

#### **Rekomandim:**

**1.1-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve, të marrë masa për hartimin e planit veprimit të detajuar dhe me masa konkrete e të matshme në zbatimin e Strategjisë Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuar.

#### **Qershor 2023**

Megjithëse në nenin 86 të “Rregullores për funksionim e institucioneve arsimore parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet:

“- Shkollat e specializuara, nën organizimin e ZVA-së, shërbejnë si qendër shkëmbimi përvojë për mësuesit e IA-ve të zakonshme që punojnë me fëmijë me AK.

- Shkollat speciale shërbejnë si qendra burimore për shkollat e zakonshme duke ndihmuar personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve, mësuesit ndihmës dhe mësuesit e IA-ve të zakonshme që kanë nxënës me AK.

*Transformimi i një shkolle/instituti të arsimit special në një qendër burimore për aftësinë e kufizuar është një proces që kalon nëpër disa etapa, të cilat kërkojnë ndryshime ligjore që prekin statutin e institutit, strukturën, stafin drejtues, mësimdhënës dhe të specializuar, kurrikulën, infrastrukturën, etj.*

Ende në Shqipëri nuk ka akte ligjore e nënligjore për ngritjen dhe funksionimin e qendrave burimore. Ministria e Arsimit dhe Sporteve nuk ka një metodologji për funksionimin e shkollave speciale si qendra burimore për FAK. Po kështu, nuk ka as një metodologji apo standarde të unifikuara për ngritjen e klasave zhvillimore nëpër IA. Krijimi dhe funksionimi i të cilave, do të mbështesë edhe më tej arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe integrimin e tyre social.

Qendrat burimore njihen në rajon dhe më gjerë si modele që mbështesin arsimimin e nxënësve me AK dhe integrimin e tyre social. Kryesisht institutet për nxënës që nuk shikojnë dhe dëgjojnë shërbejnë si qendra burimore për këto persona, duke ofruar mbështetje për arsimimin e plotë dhe gjatë gjithë jetës dhe integrimin e tyre në tregun e punës.

Në SHBA, institutet e ngjashme funksionojnë si qendra dhe institucione kërkimore që shërbejnë njëkohësisht si:

- shkollë për nxënës të verbër, të shurdhër, apo të verbër dhe të shurdhër;

- institucione ndërkombëtare që operojnë në disa shtete për të siguruar akses në arsim për miliona fëmijë në botë më probleme shikimi dhe dëgjimi;
- qendër shkencore që ofron zgjidhje dhe produkte teknologjike apo software për persona me probleme shikimi/dëgjimi dhe për institucione që integrojnë e punësojnë persona të tillë;
- qendër për të mësuarit on-line të personave të verbër apo me probleme shikimi dhe dëgjimi;
- librari online që qarkullojnë shumë tituj në alfabetin Braille, gjuhën e shenjave, audio apo me printim në format të zmadhuar.

Modele të tilla të ngjashme funksionimi kanë këto institute edhe në vendet e Evropës.

Ndërsa në vendet e rajonit dhe kryesisht në Kosovë ekzistojnë qendrat burimore për PAK, të ngritura mbi bazën e instituteve dhe shkollave ekzistuese speciale për nxënësit e verbër, me probleme dëgjimi, shkolla speciale për nxënësit me dëmtime intelektuale, të cilat si qendra burimore ofrojnë disa shërbime si: Identifikimi dhe referimi për vlerësim i fëmijëve me AK që janë jashtë shkollës dhe i atyre që janë në shkollë apo institucione parashkollore dhe që kanë nevojë për mbështetje; Mbështetja për institucionet parashkollore dhe shkollat e rregullta dhe prindërit; Mbështetja e nxënësve dhe mësuesve në shkolla jo speciale përmes mësuesve udhëtues; Formatim i punës praktike në klasë me nxënës me AK; Zhvillimi, hartimi dhe shpërndarja e materialeve ndihmëse mësimore për nxënës me AK; Ofrimi i këshillave për mësues në shkolla jospciale për punën me nxënës me AK; Organizmi i kurseve trajnuese për mësues dhe prindër të fëmijëve me AK dhe vështirësi në të nxënë që janë në shkolla jo speciale, etj. etj.

Qendrat burimore bazuar në praktikat më të mira<sup>9</sup> shërbejnë për:

- Identifikimi dhe referimi për vlerësim i fëmijëve me AK që janë jashtë shkollës dhe i atyre që janë në shkollë apo institucione parashkollore dhe që kanë nevojë për mbështetje.
- Mbështetja e nxënësve me AK dhe mësuesve që punojnë me këto nxënës në shkolla jo specifike.
- Formatim i punës praktike në klasë me nxënës me AK.
- Zhvillimi, hartimi dhe shpërndarja e materialeve ndihmëse mësimore për nxënës me AK.
- Organizmi i kurseve trajnuese për mësues dhe prindër të fëmijëve me AK dhe vështirësi në të nxënë që janë në shkolla jo specifike.
- Vlerësimi i nxënësve me AK dhe vështirësi në të nxënë të shkollave jo specifike.

### **Gjetje nga auditimi:**

**2. Ministria e Arsimit dhe Sporteve nuk ka metodologji për funksionimin e shkollave speciale si qendra burimore për FAK si dhe metodologji dhe standard të njëjtë për ngritjen e klasave zhvillimore nëpër IA,**

### **Konkluzion:**

**2. Hartimi i metodologjisë në krijimin dhe funksionimin e qendrave burimore, do të mbështesë edhe më tej arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuar, në identifikimin dhe referimin për vlerësimin e tyre, mbështetjen mësuesve që punojnë me këto nxënës në shkolla jo specifike, formatim e punës praktike në klasë, organizmin e kurseve trajnuese për mësues dhe prindër të fëmijëve të tyre, etj., të cilët ndjekin shkollat jo specifike të arsimit, me qëllim integrimin e tyre social.**

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit dhe Sporteve, të marrë masa për hartimin e metodologjisë në krijimin dhe funksionimin e qendrave burimore, ngritjen dhe funksionimin

<sup>9</sup> Dr. Murteza Osdautaj qendrat burimore në Kosovë (themelimi, funksionimi dhe perspektiva) dhe MASHT. (2019), Prishtinë Udhëzues për planifikim dhe raportim të punës së edukatoreve, mësuesve mbështetës si dhe asistentëve- Përgjegjësitë e asistentit-es për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

e klasave zhvillimore në Institucionet Arsimore për arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuar.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **Gjetje nga auditimi:**

**3.** Nga auditimi konstatohet disa mangësi të ndryshme në vlerësimin dhe sigurimin e kushteve se për nxënësit me aftësi të kufizuar si:

- nuk vlerësohen në përputhje me objektivat e vendosur në Planet Edukative Individuale,
- nuk zhvillojnë provimet në përshtatje me veçoritë e tyre nëpërmjet provimi të posaçëm kombëtar të arsimit bazë,
- nuk pajisen me dëftesë pas përfundimit të çdo klase, e cila të përmbajë rubrikën ku përshkruhen objektivat kryesorë të Planit Edukative Individual,
- nuk pajisen me dëftesën e posaçme, që nxënësi me aftësi të kufizuar ka përfunduar provimet kombëtare të arsimit bazë,
- nuk kanë kryer provimet kombëtare duke iu nënshtuar një testi të posaçëm të hartuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore,
- ka mungesa të theksuara në lidhje me sigurimin e mjeteve didaktike,
- në Institucionet Arsimore Parauniversitare nuk janë siguruar kushtet optimale të punës për ofrimin e shërbimit psiko-social
- Drejtoria e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar e Drejtoritë Rajonale të saj nuk sigurojnë monitorimin dhe inspektimin e Zyrave Vendore Arsimore dhe Institucioneve Arsimore publike në juridiksionin e tyre,.
- nga të dhënat e Ministrisë së Arsimit, përgjigjet e pyetësorëve konstatohet se jo të gjitha Institucionet Arsimore Parauniversitar janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara në të gjitha ambientet. Kështu rreth 60 % e tyre konsiderohen që garantojnë aksesin fizik, por jo në të gjithë godinën, infrastrukturën e duhur në ndihmë të nxënësve me karroca dhe nxënësve me probleme në shikim.
- në Institucionet Arsimore Parauniversitare të zakonshme nuk ka mjete didaktike për fëmijët që nuk dëgjojnë si dhe u mungojnë ambientet e dedikuara për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale.

#### **3.Konkluzion:**

Krijimi i kushteve në shkolla për nxënësit me aftësi të kufizuar në përshtatje me veçoritë e tyre, duke u kujdesur për nevojat individuale, përmirësimin të reformave kurrikulare, vlerësimin të tyre, përmirësimin të mjeteve didaktike, përmirësimin të infrastrukturës në të gjithë godinën e shkollës në ndihmë të nxënësve me probleme, etj., në përmbushje të standardeve dhe të kompetencave themelore për të nxënësit gjatë gjithë jetës, duhet të jetë detyrë parësore, përgjatë veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare, sepse bën të mundur arritjen e objektiveve që synon gjithëpërfshirjen në arsimim, evidentim të aftësive, dijeve, qëndrimeve dhe vlerave që duhet të ketë gjithsecili prej tyre.

#### **Rekomandim:**

**3.1** Ministria e Arsimit dhe Sporteve në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të marrë masa për hartimin e testeve kombëtare, hartimin e dëftesave të posaçme, zhvillimin e provimeve të posaçëm kombëtar të arsimit bazë, pajisen me dëftesë pas përfundimit të çdo klase dhe përfundimtare, sigurimin e mjeteve didaktike, përmirësimin të infrastrukturës së godinave shkollore, në përshtatje me veçoritë e nxënësve me aftësi të kufizuar.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.2** Ministria e Arsimit dhe Sporteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar të monitorojnë dhe inspektojnë Zyrat Vendore Arsimore dhe Institucionet Arsimore publike për realizimin e mësim dhënies për nxënësit me aftësi të

kufizuar si dhe të sigurojnë kushtet optimale të punës për ofrimin e shërbimit psiko-social në Institucionet Arsimore Parauniversitare, dhe Drejtoritë Rajonale të saj.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Gjetje nga auditimi:**

**4.** Nga inspektimet e realizuara nga grupi i auditimit në Zyrën Vendore Arsimore Fier, Durrës, Korçë, Tiranë, Lezhë, u konstatua se jo të gjitha Institucionet Arsimore Parauniversitare janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara në të gjitha ambientet. Nga të dhënat e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve rezultojnë që rreth 60 % e shkollave në të gjithë Republikën e Shqipërisë konsiderohen që garantojnë aksesin fizik të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Por, edhe në këto raste jo e gjithë godina është e aksesueshme, në pjesën më të madhe vetëm katet e para. Në shkollat që ka nxënës me aftësi të kufizuara dhe nuk ka akses për lëvizshmërinë e tyre, ata ndihmohen nga prindërit dhe mësuesit për të mundësuar vijimin e procesit mësimor.

Shkollat nuk e kanë në të gjithë godinën, infrastrukturën e duhur në ndihmë të nxënësve me karroca dhe nxënësve me probleme në shikim. Gjithashtu, në Institucionet Arsimore Parauniversitare të zakonshme nuk ka mjete didaktike për fëmijët që nuk dëgjojnë. Shkollave në tërësi u mungojnë ambientet e dedikuara për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale.

**Konkluzion:**

**4.1** Lidhur me realizimin e të drejtës për të patur akses në arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duhet të sigurohet mundësia e përdorimit të mjediseve shkollore në përputhje me Konventën për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, përmes sigurimit të masave specifike të tilla si materiale të aksesueshme dhe të përshtatura.

**Rekomandimi:**

**4.1-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të planifikojë kryerjen e investimeve në të gjitha shkollat e vendit duke i kthyer ato në mjedise të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara me qëllim rritjen e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

**Në vijimësi**

**4.1.2. Si ka qene niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional për implementimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara?**

Për të realizuar prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (2021-2026), ku sigurimi i një arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës zë vendin kryesor, MAS-i ka bashkëpunuar ngushtë me organizata të shoqërisë civile dhe agjenci të ndryshme të UN, si UNICEF, Save the Children, World Vision, MEDPAK, UNDP etj.

Në bashkëpunim me “Save the Children”, është realizuar trajnimi i Komisioneve Multidisiplinare të AK të ish-DAR/ZA Durrës, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Peshkopi, Korçë, Burrel, për “Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit”.

Me mbështetjen e UNICEF, është hartuar moduli “Edukimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen-profilin e mësuesit gjithëpërfshirës”, miratuar nga MAS me urdhrin nr.195, datë 25.04.2016, i cili shërben si bazë kompetencash për zhvillimin profesional dhe të vazhdueshëm të mësuesve në përgjithësi dhe të atyre që punojnë për gjithëpërfshirjen në arsim të fëmijëve me AK, mësuesve ndihmës etj.

Moduli është konceptuar si një udhëzues për hartimin dhe zbatimin e programeve për zhvillimin profesional të mësuesve, duke përcaktuar disa vlera dhe 4-5 kompetenca themelore

si; Vlerësimi i diversitetit mes nxënësve; përshtatja e qëndrimeve dhe sjelljeve në lidhje me dallimet mes nxënësve; nxitja e të nxënësve akademik, praktik, social dhe emocional për të gjithë nxënësit; metodologji efektive të mësimdhënies në klasat me përbërje diverse; puna me prindërit dhe familjet etj., si dhe ka të përcaktuar qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë profesionale të mësuesit si elementë përbërës për çdo kompetencë.

Në qershor 2018 në bashkëpunim me Save the Children është mundësua trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale, ku kanë marrë pjesë 42 drejtues të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës. Në shtator 2018, zyra e UNICEF në Tiranë në bashkëpunim me MAS dhe ASCAP ka zhvilluar trajnimin e drejtuesve të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës. Trajnimi është zhvilluar nga konsulent të UNICEF, ekspert të njohur ndërkombëtar, me mbi 30 vjet eksperiencë në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës, mbrojtjes dhe zhvillimit të fëmijës, barazisë në arsim, etj.

Gjithashtu, në shërbim të gjithëpërfshirjes, nga bashkëpunimi me World Vision është arritur hapja dhe funksionimi, duke filluar nga dhjetori 2018, i 17 hapësirave zhvillimore në shkolla të arsimit bazë në Kamzë, Durrës, Kurbin, Lezhë, Shkodër, Elbasan, Përrenjas, Korçë, 2 në Dibër dhe 2 në Tiranë.

Hapësirat zhvillimore shërbejnë për të punuar për objektivat e Planit Edukativ Individual për fëmijët me aftësi të kufizuara, kryesisht objektiva zhvillimore që nuk arrihen dot brenda klasës; Terapi individuale/ shërbime sipas Planeve Edukative Individuale për fëmijët me AK dhe shërbimi i logopedisë; Psiko-edukim për çdo fëmijë (*punë në grupe e organizuar nga psikologu i shkollës dhe aty ku ka punonjës social*); Përdorim i hapësirës për art-terapi me grupe fëmijësh; Përdorimi i materialeve nga hapësirat në klasat e zakonshme nga mësuesit lëndor, etj.

World Vision, ka mbështetur hartimin e modulit të trajnimit për mësuesit e edukimit fizik "*Sportet e unifikuara*", i cili konsiston në dhënie informacioni mbi metodologjinë e ngritjes dhe trajnimit të ekipeve të unifikuara me fëmijë me dhe pa aftësi të kufizuara intelektuale, në sportet e futbollit, basketbollit dhe volejbollit.

Gjatë vitit 2020-2021 disa veprimtari trajnuese për MN janë zhvilluar në bashkëpunim dhe me mbështetjen e programit të UNDP "*Asnjë të mos mbetet pas*".

**-Referuar përgjigjeve të dhëna nga ZVAP, mbi nivelin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave speciale me shkollat e zakonshme në kuadër të shkëmbimit të përvojës për mësuesit të cilët punojnë me fëmijët me AK, rezulton se** në kuadër të shkëmbimit të përvojës për mësuesit të cilët punojnë me fëmijët me AK janë organizuar rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës. Këto rrjete janë organizuar të tilla që në përbërje të tyre të kenë mësues si nga shkollat zakonisht edhe nga shkollat e arsimit special. Në takimet e rrjeteve profesionale, por edhe më gjerë sipas nevojave individuale, ndihma ka konsistuar në: mënyrën e hartimit të PEI, teknika specifike të punës sipas llojeve të AK, teknika të menaxhimit të sjelljeve problematike të fëmijëve me AK, teknika për nxitjen e ndërveprimit social dhe arritjen e gjithëpërfshirjes.

-Në vitin 2015, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD) realizoi studimin "Personat që nuk dëgjojnë në Shqipëri, 2015". Bazuar në rezultatet e studimit një nga përfundimet është se personat që nuk dëgjojnë në Shqipëri, nuk gëzojnë mundësi të njëjta si ata që dëgjojnë në lidhje me jetesën e pavarur dhe arsimimin. Gjatë viteve në vazhdim, është arritur progres në përmirësimin e të nxënësve të gjuhës së shenjave shqiptare, për rritjen e cilësisë së arsimimit të nxënësve që nuk dëgjojnë, deri në nivelin e arsimit të mesëm. Për të trajtuar problemet në këtë fushë është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit nr. 4481, datë 25.4.2018, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shoqatës Kombëtare

Shqiptare të Personave që nuk Dëgjojnë, për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe ofrimin e shërbimeve të interpretimit në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë.<sup>10</sup>

Bazuar në përgjigjet e pyetësorëve për pyetjet në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional **me strukturat e tjera (bashkitë, Ministrin e Brendshme, njësitë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve) për evidentimin e fëmijëve të cilët duhet të ndjekin arsimin bazë** rezultoi se:

Përvoja për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, në zbatim të marrëveshjes së përbashkët midis tri ministrive ka qenë përgjithësisht pozitive.

Bashkëpunimi ka konsistuar në evidentimin e fëmijëve në detyrim shkollor dhe në raportim të rasteve kur fëmijët në detyrim shkollor nuk regjistrohen në klasë të parë ose konsiderohen potencialisht braktisës.

Çdo fillim viti ZVAP merr nga MB, listën e fëmijëve të moshës shkollore të cilët duhet të ndjekin arsimin bazë dhe në bashkëpunim me Institucionet Arsimore Parauniversitare verifikon shkollën ku çdo fëmijë është regjistruar.

Për vitin shkollor 2021-2022, në një numër shkollash të ZVAP Tiranë u aplikua pilotimi i regjistrimit në shkollë në mënyrë elektronike përmes e-Albania në sistemin SMIP. Kjo mënyrë lehtësoi identifikimin e fëmijëve të regjistruar në kohë reale.

ZVAP për disa fëmijë, të cilët kanë qenë mbartës të disa diagnozave dhe nuk kanë fituar aftësitë minimale për fillimin e procesit të edukimit, është pranuar shtyrja e regjistrimit të tyre në arsimin e detyruar deri në kufirin maksimal të moshës së pranimit.

Ka patur edhe raste kur prindi ka kërkuar të regjistrojë fëmijën në shkollë përtej kufirit maksimal të pranimit, në këto raste mundësohet regjistrimi në shkollë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore të posaçme të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

**- Niveli i bashkëpunimit ndërmjet shkollave speciale me shkollat e zakonshme në kuadër të shkëmbimit të përvojës për mësuesit të cilët punojnë me fëmijët me AK.**

**DRAP Fier** - Në ZVAP-et të cilat kanë shkolla të edukimit special bashkëpunimi është shumë pozitiv.

**DRAP Durrës** - Në kuadër të shkëmbimit të përvojës për mësuesit të cilët punojnë me fëmijët me AK janë organizuar rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës. Këto rrjete janë organizuar të tilla që në përbërje të tyre të kenë mësues si nga shkollat zakonshme ashtu edhe nga shkollat e arsimit special. Në takimet e rrjeteve profesionale, por edhe më gjerë sipas nevoja individuale, ndihma ka konsistuar në: mënyrën e hartimit të PEI, teknika specifike të punës sipas llojeve të AK, teknika të menaxhimit të sjelljeve problematike të fëmijëve me AK, teknika për nxitjen e ndërveprimit social dhe arritjen e gjithëpërfshirjes.

**DRAP Lezhë** - Rrjeti profesional i mësuesve ndihmës ka shkëmbyer eksperience me mësuesit e shkollës speciale. “3 Dhjetori” në Shkodër.

**DRAP Korçë** - Bashkëpunimi ka qenë në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave në mësimdhënie të fëmijëve me aftësi ndryshe.

#### -Aksesueshmëria

KDPAK përmes nenit 9 vendos mbi shtetet palë detyrimin për të eliminuar barrierat në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë e sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruar për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Shtetet duhet të marrin masa përmes identifikimit të barrierave dhe eliminimit të tyre në ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, **përfshirë shkollat**, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës, informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës.

<sup>10</sup> VKM nr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”


Nga analizimi i të dhënave statistikore të vëna në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve konstatohet se jo të gjitha Institucionet Arsimore Parauniversitare janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara në të gjitha ambientet e tyre. Në grafikun e mëposhtëm me nr.11 jepen të dhënat për infrastrukturën në IA, për fëmijët me aftësi të kufizuar për vitet 2020 – 2021 ku shikohet qartë se përmirësime të dukshme ka në lidhje me hyrjen për në katin përdhe të shkollës dhe me numrin e tualeteve për personat me aftësi të kufizuara ndërsa pjesa tjetër nuk plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose i plotësojnë në nivel shumë të ulët.

Të dhënat e mëposhtme i referohen infrastrukturës fizike apo barrierave arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe jo personave me aftësi të kufizuara në shikim, dëgjim dhe të folur, apo personave me aftësi të kufizuar në sferën intelektuale. Për sa më sipër të dhënat e përfshira në grafik janë vetëm për arsimin gjithëpërfshirës në shkollat përgjithshme, ndërkohë që MAS nuk disponon dhe analizon të dhëna për mjetet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuar në shikim, dëgjim dhe të folur, apo personave me aftësi të kufizuar në sferën intelektuale. Disa prej drejtuesve të IA gjatë intervistave pohonin që fëmijët me aftësi të kufizuara në shikim apo dëgjim rrallëherë shkojnë në këto institucione për të marrë shërbimet që ofrohen duke zgjedhur shkollat speciale të cilat kanë kushte më të përshtatshme për ta.

Grafiku nr.10, “Infrastruktura hidrosanitare dhe elektrike në %, ndaj numrit total të shkollave prej 2,163 (arsim 9 vjeçar + AML)”



Grafiku nr.11, “Të dhëna për infrastrukturën për fëmijët me aftësi të kufizuar për vitet 2020 - 2021.



Burimi i informacionit: Drejtoria e statistikave MAS

Gjetje nga auditimi:

5. Nxënësit me aftësi të kufizuar vlerësohen në përputhje me objektivat e vendosur në Planet Edukative Individuale përkatës dhe i zhvillojnë provimet në përshtatje me veçoritë e tyre. 11 Nxënësit me aftësi të kufizuar që nuk kanë mësuar me programet e zakonshme i nënshtrohen një provimi të posaçëm kombëtar të arsimit bazë dhe të Maturës Shtetërore, testet e të cilit hartohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuar pas përfundimit të çdo klase, pajiset me dëftesë e cila duhet të përmbajë një rubrikë ku përshkruhen përmbledhtas objektivat kryesorë të Planit Edukative Individual të tij. Ndërsa nxënësi me aftësi të kufizuar që ka përfunduar me sukses provimet kombëtare të arsimit bazë, pajiset me dëftesën e posaçme. Gjatë viteve objekt auditimi nxënësit me aftësi të kufizuar kanë kryer provimet kombëtare pa iu nënshtuar një testi të posaçëm të hartuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Gjithashtu nuk ka dëftesa të posaçme për ta sipas standardit të kërkuara të sipërcituar.

**Konkluzion:**

5.1 Mos vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuar në përshtatje me veçoritë e tyre nuk jep një rezultat real të arritjeve të tyre duke u vlerësuar fiktivisht.

**Rekomandim;**

5.1- Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve / Qendra e Shërbimeve Arsimore, të marrë masa për hartimin e testeve kombëtare në përshtatje me veçoritë e nxënësve me aftësi të kufizuar si dhe hartimin e dëftesave të posaçme me qëllim që edhe ata të marrin rezultatet e punës mësimore dhe arritjet bazuar në objektivat e vlerësuar dhe të vendosur në Planet Edukative Individuale.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

Mjetet didaktike të nevojshme për fëmijët me AK

Nga përgjigjet e pyetësorit të hartuar nga grupi i auditimit të KLSH drejtuar Drejtorive Rajonale Arsimore Parauniversitare rezultoi se:

DRAP	Përgjigja përkatëse
Fier	Është bërë pajisja pjesërisht me mjete didaktike të veçanta, kryesisht me ndihmën e vetë mësuesve ndihmës që asistojnë fëmijën/t.
Durrës	Jo, këta fëmijë nuk janë pajisur me mjetet e nevojshme didaktike
Lezhë	Po janë pajisur nëpërmjet projekteve.
Korçë	Evidentohet një rast për një nxënës me aftësi të kufizuar në shikim.



*Foto: Mjete didaktike të siguruar nga vete mësuesit për të kryer procesin mësimor.*

Nga auditimet në terren e konkretisht në Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitare Lezhë, Korçë dhe Durrës, rezulton se këto pajisje janë siguruar vetëm në disa shkolla ku janë hapur klasa zhvillimore nga projekti me Word Vision pra, jo nga fondet e buxhetit të shtetit, si dhe në rastet e shkollave pilot për arsimin gjithëpërfshirës. Si rast pozitiv përmendim ngritjen e klasës zhvillimore në shkollën 9-vjeçare “Shkolla e Re” në Kënetë, ZVA Durrës. Kjo klasë ishte e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme dhe funksiononte jo vetëm për

<sup>11</sup> Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitar në Republikën e Shqipërisë (neni 84),

fëmijët me AK, por për të gjithë fëmijët e shkollës duke i ardhur në ndihmë arsimit gjithëpërfshirës.



*Foto: Ambiente të hapësirave zhvillimore me larmi pajisjesh për të punuar me Fëmijët me AK  
Foto të kryera nga grupi i auditimit*

#### **Gjetje nga auditimi:**

6. Nga auditimi në terren në Institucionet Arsimore Parauniversitare dhe Zyrat Vendore Arsimore, rezultoi se kishte mungesa të theksuara në lidhje me sigurimin e mjeteve didaktike të veçanta për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara, përgjithësisht këto mjete siguroheshin nga vetë mësuesit ndihmës dhe në disa raste nga prindi/kujdestari ligjor.

#### **Konkluzioni:**

6. Mungesa e mjeteve didaktike ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e mësimin dhe realizimin e programit individual për fëmijët.

#### **Rekomandimi:**

6.1- Ministria e Arsimit dhe Sporteve të marrë masa për të evidentuar nevojat për mjete didaktike duke siguruar mbështetje dhe përshtatje të individualizuara për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.

#### **Brenda 6 muajit të parë të 2023**

#### **Gjetje nga auditimi:**

7. Bazuar në të dhënat e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitare në varësi të Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, Durrës, Lezhë, Korçë rezultoi se nuk janë siguruar kushtet optimale të punës për ofrimin e shërbimit psiko-social në Institucionet Arsimore Parauniversitare. Ky shërbim ka shumë mungesa në infrastrukturë (*zyrë, kompjuter, printer, materiale kancelarie*), ku përgjithësisht çdo punonjës i siguron vetë mjetet e domosdoshme për ofrimin e shërbimit.

#### **Konkluzion:**

7. Mos sigurimi i kushteve optimale të punës për ofrimin e shërbimit psiko-social në Institucionet Arsimore Parauniversitare ndikon drejtpërdrejt në marrjen e shërbimit.

#### **Rekomandimi:**

7.1- Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, Durrës, Lezhë, Korçë, të marrin masa për të siguruar kushtet optimale të punës për ofrimin e shërbimit psiko-social në Institucionet Arsimore Parauniversitare nën juridiksionin e tyre.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **Gjetje nga auditimi:**

**8.** Strukturat e ngritura në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*Fier, Durrës, Lezhë, Korçë*) nuk janë të mjaftueshme dhe nuk sigurojnë monitorimin dhe inspektimin e Zyrave Vendore Arsimore dhe Institucioneve Arsimore publike në juridiksionin e tyre. Këto struktura kanë nevojë për shërbime mbështetëse për realizimin e monitorimit sistematik për ngritjen dhe funksionimin e veprimtarisë së Komisioneve të Institucioneve Arsimore të Zakonshme për Aftësinë e Kufizuar. Vetëm në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë janë rreth 670 nxënës me aftësi të kufizuara të cilët kanë ndjekur shkollën në distancë sipas Planit Edukativ Individual, ku për shkak të strukturave të pamjaftueshme nuk janë kryer monitorime apo inspektime të dedikuara për realizimin e mësimin për këta fëmijë.

**Konkluzion:**

**8.** Strukturat e monitorimit dhe inspektimit janë sektori i monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare dhe sektori i inspektimit dhe vlerësimit të cilësisë në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar. Këto struktura funksionojnë bazuar në kushtet e përshtatshme që këto organizma duhet të kenë.

**Rekomandimi:**

**8.1-** Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar të marrin masa për monitorimin dhe inspektimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në çdo aspekt të procesit mësimor por, me programe të veçanta edhe për realizimin e mësim dhënies për Aftësinë e Kufizuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.2. A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare me fonde si në nivel qendror dhe vendor për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e nxënësve me aftësi të kufizuara?**

Në ligjin nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Para universitar në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 37, 38 dhe 40 që bëjnë fjalë për financimin e arsimit parauniversitar, përcaktohet:

**1.** Burimet për financimin e arsimit parauniversitar janë:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) Të ardhurat e njësive të qeverisjes vendore;
- c) Dhurimet e sponsorizimet;
- d) Të ardhurat e përftuara nga Institucionet Arsimore Parauniversitare;
- e) Të ardhura të tjera të ligjshme.

- Në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23, “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, në pikën 11 citohet se: “Bashkitë janë përgjegjëse për “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale”.

Në zbatim të sa më sipër, për një gjykim sa më profesional në lidhje me performancën e mbështetjes financiare për aftësimin dhe integrimin e barabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin gjithëpërfshirës (aksesueshmërinë dhe përshtatshmërinë), auditimi u përqendrua dhe u mbështet kryesisht në: programet buxhetore të realizuara, statistikat, evidencat dhe të dhënat e grumbulluara në: Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (Drejtorinë e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar), në DRAP: Durrës, Lezhë, Korçë dhe Fier, në ZVAP: Tiranë, Durrës, Lezhë, Korçë dhe Fier si dhe në përgjigjet të pyetësorëve përkatës, intervistave të zhvilluara me strukturat dhe personat përgjegjës të këtyre subjekteve, të cilët mbulonin sektorët e financës, buxhetit, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë:

## 1. Ministria e Arsimit dhe Sportit

Sipas raporteve të monitorimit dhe të dhënave të marra nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për periudhën 2019-2021, fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për arsimin parauniversitar në rang vendi dhe sa zënë ato ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Shpenzimeve Publike, paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 5: Shpenzimet për arsimin para universitar në rang vendi ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Shpenzimeve Publike:


000 lekë

Nr.	Kategoria e shpenzimeve	2019	2020	2021
1	Buxheti i MAS-së për arsimin	39,923,715	39,235,038	41,906,020
2	Fonde të tjera për arsimin nga institucione të ndryshme	4,476,000	4,319,000	4,396,000
3	Fonde për arsimin të NJQV-ve	8,237,231	7,617,629	<b>15,646,029</b>
4	Të ardhurat te tjera publike për arsim, ndihma donacione, grante, etj.	3,047,986	2,986,334	<b>2,332,951</b>
<b>5</b>	<b>Gjithsej fonde për arsimin (1+2+3+4)</b>	<b>55,684,932</b>	<b>54,158,000</b>	<b>64,281,000</b>
6	Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)	<b>1,691,727,000</b>	<b>1,617,541,000</b>	<b>1,769,258,000</b>
7	Shpenzime për arsimin në % ndaj PBB-së dhe ndaj shpenzimeve publike (5/6)	3.3	3.3	3.6
<b>8</b>	<b>Gjithsej, shpenzimet publike</b>	<b>491,897,000</b>	<b>536,279,000</b>	<b>610,199,000</b>
9	Shpenzime për arsimin në % ndaj shpenzimeve publike (5/8)	11.3	10.1	10.5

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Grafikisht (grafiku nr.12) duket qartë se për vitin 2020 kemi një ulje të shpenzimeve për arsimin parauniversitar ndaj shpenzimeve publike.


Grafiku nr.12.



Burimi i të dhënave MAS

Nga të dhënat e përgatitura nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe paraqitur grupit të auditimit, zërat e shpenzimeve për arsimin parauniversitar në rang vendi në të cilat janë përfshirë edhe shpenzimet për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar, paraqiten në grafikun nr.13. sipas viteve sa vijon:

Grafiku nr.13:



*Burimi i të dhënave MAS*

*Më hollësisht: Aneks 4.2, Tabela 1: Zërat e shpenzimeve për arsimin parauniversitar në rang vendi në të cilat përfshihen edhe shpenzimet për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar” dhe Tabela 2. Shpenzimet për arsimin në rang vendi për fëmijët me Aftësi të Kufizuar, në % ndaj: shpenzimeve për arsimin parauniversitar, Prodhimi i Brendshëm Bruto dhe Shpenzimeve Publike” bashkëlidhur shtojcave.*

Sa më sipër e tregohet se këto shpenzime kanë ardhur në rritje, pavarësisht se në vlera të ulëta, nga viti 2019 në vitin 2021.

Në zërat e shpenzimeve ku janë të përfshirë dhe FAK rezulton se:

- nuk janë të dedikuara si shpenzime të veçanta buxhetore të destinuar vetëm për FAK, por janë përfshirë së bashku,
- po kështu edhe shpenzimet për kualifikimin dhe trajnimin e mësuesve ndihmës apo asistentëve të tyre, apo shpenzimet për investimet në aksesueshmërinë dhe përshtatshmërinë në shkolla etj., nuk janë të dedikuara si shpenzime të veçanta buxhetore të destinuar vetëm për FAK por janë përfshirë së bashku me shpenzimet e tjera.

**Sa më sipër,** nivelet e ulëta të financimit përveç se, janë çështjet kryesore që ndikojnë negativisht në rezultatin e përgjithshëm të arsimit parauniversitar, ndikojnë negativisht edhe në integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në arsimin gjithëpërfshirës, pasi për shkak të specifikave me efekte të ndjeshme sociale si dhe të vështirësive që kanë me shëndetin, integrimi i tyre jo vetëm në arsimin gjithëpërfshirës por edhe në tërë jetën shoqërore kërkon një buxhet më të shtuar dhe të dedikuar enkas për ta.

Nivelet e pakënaqshme të financimit nga buxheti i shtetit për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në arsimin gjithëpërfshirës dhe problematikat që vijnë nga mos programimi dhe mos parashikimi i buxheteve të veçanta për këtë shtresë vulnerabël të shoqërisë u shfaqen dukshëm në auditimin që kryem në disa institucionet vendore të arsimit parauniversitar, si më poshtë:

## **2. Në Drejtoritë Arsimore Rajonale Parauniversitar (DRAP):**

Shpenzimet ndaj PBB, ndaj shpenzimeve publike dhe shpenzimet që i dedikohen vetëm fëmijëve me AK sipas DRAP-eve paraqiten në tabelën sa më poshtë vijon:

*Tabela nr.6: Shpenzimet ndaj PBB, ndaj shpenzimeve publike dhe shpenzimet që i dedikohen vetëm fëmijëve me AK sipas DRAP-eve*

Shpenzimet	Durrës			Lezhë			Korçë			Fier		
	2019	2020	2021	2019	2020	2021	2019	2020	2021	2019	2020	2021
Shpenzimet ndaj PBB	0.00027 %	0.00013 %	0,0002 %	0.0001 %	0.00036 %	0,0004 %	0.001 %	0.002 %	0,003 %	0.00047 %	0.00036 %	0,00027 %
Shpenzimet ndaj shpenzimeve publike	0.0093 %	0.0042 %	0.0059 %	0.00035 %	0.011 %	0.011 %	0.003 %	0.003 %	0.01 %	0.016 %	0.001 %	0.007 %
Shpenzimet që dedikohen vetëm për FAK	0	166,589	160,584	0	0	0	0	0	0	0	0	0

*Burimi i të dhënave DRAP-et*

Nga ku rezulton se: Për të tre vitet nuk është planifikuar apo kërkuar buxhet i veçantë për mbulimin e shpenzimeve për fëmijët me aftësi të kufizuar.

### **3. Në Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitar (ZVAP):**

Nga auditimi në Zyrën Vendore Arsimore Parauniversitare Tiranë, Durrës, Lezhë, Korçë-Pustec dhe Fier rezultoi se kanë kryer shpenzime të dedikuara për fëmijët me aftësi të kufizuar vetëm për pagat e mësuesve ndihmës që merren direkt me mësimdhënien e tyre dhe pagat e punonjësve psiko-sociale, të cilët përveç fëmijëve me aftësi të kufizuar merren dhe me arsimin e nxënësve në përgjithësi. Ndërsa Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare Fier ndryshe nga Zyrat Vendore Arsimore të tjera të audituara ka mbajtur të dhëna ekstra buxhetore për shpenzimet e kryera të dedikuara për fëmijëve me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës në këtë Zyrë Vendore Arsimore Parauniversitare. Megjithatë për të tre vitet nuk është planifikuar apo kërkuar buxhet të veçantë për mbulimin e shpenzimeve për fëmijët me aftësi të kufizuar. *(shiko tabelat në Aneksin 2., bashkëlidhur)*

Për periudhën objekt auditimi, Ministria e Arsimit dhe e Sportit si dhe institucionet vendore të arsimit parauniversitar përgjegjës për integrimin në arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuar, nuk kanë planifikuar buxhet specifik të veçantë mbështetur në numrin faktik të fëmijëve me aftësi të kufizuar që janë duke frekuentuar arsimin gjithëpërfshirës apo që pritet të frekuentojnë këtë arsim në vitet në vazhdim. Buxhetet për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor nuk janë programuar, planifikuar dhe dedikuara si shpenzime specifike të veçanta buxhetore, por janë përfshirë së bashku me zërat e tjerë të shpenzimeve të përgjithshme të arsimit parauniversitar. Përmendim shpenzimet për: pagat e mësuesve ndihmës apo asistentëve; kualifikimi dhe trajnimin e mësuesve ndihmës apo asistentëve, për tekstet shkollore dhe mjetet didaktike speciale, transportin e nxënësve, Investimet për aksesueshmërinë dhe përshtatshmërinë në shkolla, apo edhe ndonjë zë shpenzimi specifik të diktuar sipas rastit të veçantë të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Niveli i ulët i financimit nga buxheti i shtetit për fëmijët me aftësi të kufizuar në arsimin gjithëpërfshirës dhe mos programimi dhe mos parashikimi i buxheteve të veçanta enkas për këtë shtresë vulnerabil të shoqërisë, krijon problematika në integrimin e tyre, pa diskriminim dhe të barabartë, në arsimin gjithëpërfshirës. Konkretisht:

-Shpenzimet për pagat e mësuesve ndihmës, programohen, planifikohen dhe realizohen së bashku me shpenzimet për pagat e të gjithë mësuesit e tjerë. Ndërkohë mësuesit ndihmës kanë vështirësi në mësimdhënie dhe paguhen me pagë të njëjtë me mësuesit e tjerë dhe nuk përfitojnë shpërblim shtesë për vështirësi dhe përkujdesje të shtuar.

- Kualifikimi dhe trajnimi i të gjithë mësuesve përfshi edhe mësuesit ndihmës në rang vendi, në nivel qendror kryhet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe mbulohet nga fondet buxhetore që i akordohen këtij institucioni për këtë qëllim. Ndërsa në

nivel vendor mbulohet nga Drejtori Rajonale Arsimore Parauniversitare nga fondet buxhetore që i akordohen nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve në zërin kualifikime dhe trajnime për të gjithë mësuesit e rajonit. Këto shpenzime përfshihen në shpenzimet totale që këto institucione shpenzojnë për kualifikimin dhe trajnimin e mësuesve të arsimit parauniversitar. Konstatohet se, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, nuk janë kryer shpenzime për kualifikime dhe trajnime të veçanta për mësuesit ndihmës.

- Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitar, përveç fondeve që marrin nga buxheti i shtetit për ushtrimin e aktivitetit të tyre, marrin fonde edhe për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e mjeteve didaktike mësimore për Institucionet Arsimore Parauniversitare që kanë në juridiksionin e tyre. Shpenzimet për blerjen e mjeteve didaktike speciale enkas të fëmijëve me aftësi të kufizuar, nuk janë të dedikuara si shpenzime të veçanta buxhetore por janë përfshirë së bashku me shpenzimet e tjera për blerjen e mjeteve didaktike në tërësi (kancelari, etj.).

- Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitar dhe Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitar, marrin nga buxheti i shtetit fonde për mbulimin e shpenzimeve për transportin e nxënësve në tërësi, ku përfshihen edhe transporti i fëmijëve me aftësi të kufizuar. Konstatohet se, në shumicën e Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore Arsimore nuk janë lidhur kontrata me subjekte private për transportin e nxënësve në tërësi, për shkak të vështirësive të ndryshme objektive apo subjektive që kanë këto institucione publike në realizimin e procedurave të prokurimit. Në këto kushte, transporti i nxënësve përfshi edhe ata me aftësi të kufizuar bëhet nga vetë prindërit, dhe për këtë arsye atyre u kompensohet (u paguhet) tarifa e transportit sipas përcaktimeve të VKM përkatëse. Për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar, për vetë aspektin social që kanë u shtohet edhe shoqërimi vajtje-ardhje i fëmijës në shkollë. Ky veprim krijon probleme sociale jo vetëm për fëmijën por për të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes të cilët duhet të jenë të angazhuar gjatë ditës me përkujdesjen e tij, duke i vështirësuar më tej jetën e përditshme.

- Investimet për aksesueshmërinë dhe përshtatshmërinë në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuar nuk kryhen nga institucionet e arsimit parauniversitar, por nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Nuk ka të dhëna për vlerat dhe shkollat në rangë vendi për investimet e kryera nga to për aksesueshmërinë dhe përshtatshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Këto investime nuk janë të dedikuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore si shpenzime të veçanta buxhetore të destinuara vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuar por janë përfshirë së bashku me investimet e tjera që bëjnë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore si në shkolla ekzistuese dhe në shkolla që ndërtohen rishtazi

#### **Gjetje nga auditimi:**

**9.** Ministria e Arsimit dhe e Sportit si dhe institucionet vendore të arsimit parauniversitar përgjegjës për integrimin në arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuar, nuk kanë planifikuar buxhet specifik të veçantë mbështetur në numrin faktik të fëmijëve me aftësi të kufizuar, por janë përfshirë së bashku me zërat e tjerë të shpenzimeve të përgjithshme të arsimit parauniversitar duke krijuar problematika në integrimin e tyre, pa diskriminim dhe të barabartë, në arsimin gjithëpërfshirës.

#### **Konkluzion:**

**9.** Nivelet e financimit janë çështjet kryesore që ndikojnë negativisht në rezultatin e përgjithshëm të arsimimit të nxënësve dhe veçanërisht, arsimimit parauniversitar të fëmijëve me aftësi të kufizuar, gjë e cila do të mundësonte, arsimin gjithëpërfshirës, përmirësimin e procesit të mësim nxënies, integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe përfshirjen në tregun e punës.

#### **Rekomandimi:**

**9.1-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve të parashikojë dhe detajojë buxhet me vete të ndarë sipas zërave buxhetore për arsimin parauniversitar të fëmijëve me aftësi të kufizuara sipas Drejtorive Rajonale Arsimore Parauniversitare.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**9.2** Ministria e Arsimit dhe Sporteve, të ngrejë grup pune të përbashkët me institucionet vendore të arsimit parauniversitar për të analizuar kërkesat dhe nevojat e domosdoshme që kanë fëmijët me aftësi të kufizuara për ndjekjen e pa diskriminuar dhe të barabartë të arsimit gjithëpërfshirës. Në bazë të këtyre kërkesave dhe nevojave, të përcaktojë nivelin e shpenzimeve publike për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, bazuar në parashikime reale, mbështetur në numrin faktik të fëmijëve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë arsimin gjithëpërfshirës apo të fëmijëve që do të identifikohen me aftësi të kufizuara që pritet të ndjekin këtë arsim në vitet në vazhdim.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**9.3-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, gjatë hartimit të projekt buxheteve vjetore duhet të parashikojë buxhet me vete të ndarë sipas zërave buxhetore të veçantë për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin gjithëpërfshirës, apo të kërkojë që në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të krijohet një fond rezervë që do të përdoret me distancë vetëm për ta dhe t'ia alokojë sipas rasteve Zyrtare Vendore Arsimore Parauniversitare apo Drejtorive Rajonale Arsimore Parauniversitare.

#### **Në vijimësi**

**4.3. A janë ndërmarrë marra masa për ngritjen dhe funksionimin e strukturave të përshtatshme për aftësimin dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim?**

**4.3.1 A janë marrë masa për trajnimin e mësuesve ekzistues dhe rekrutimin e MN?**

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Shqipëri përcakton prindin si një nga mbështetësit kryesor në arsimimin e fëmijëve. Ky ligj promovon bashkëpunimin midis të gjithë aktorëve në shkollë përfshirë këtu drejtorin e shkollës, shërbimin psiko-social në institucionet arsimore, oficerin e sigurisë, bordin e shkollës, qeverinë e nxënësve etj. Në Rregulloren “Për funksionimin e institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, Janar 2020, Kreu XIV i dedikohet arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky kapitull është një orientues shumë i mirë, duke përcaktuar punën e çdo strukture përfshirë dhe prindërit, në lidhje me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në nenin 75, kreu XIV specifikohet se “Komisioni me kërkesën e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës ose të drejtorit të IA-së, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij” dhe “personi që ushtron përgjegjësinë prindërore i paraqet komisionit në ZVA raportin vlerësues të fëmijës së tij të kryer nga komisioni mjekësor, kur fëmija është vlerësuar nga ky komision mjekësor.” Është pikërisht Komisioni në ZVA i cili “njofton personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës” dhe “bazuar në rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar cakton mësuesin ndihmës për fëmijët me AK sipas nevojave individuale të tyre”.

Mësuesi ndihmës jep ndihmesën e tij për zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik të nxënësve me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me psikologun, mësuesin kujdestar, mësuesin e lëndës dhe punonjës social në Institucionet Arsimore Parauniversitare të zakonshme, duke hartuar një program edukativ individual të nxënësit i cili miratohet nga Komisioni i shkollës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Roli i mësuesve ndihmës në sistemin arsimor është përcaktues në lidhje me mbarëvajtjen në mësimet të nxënësve me aftësi të kufizuara. Vendosija e mësuesit ndihmës, në sistemin

arsimor parauniversitar ka filluar me ligjin 69/2012, “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2014-2020.

Në Udhëzimin e MAS, nr. 38, datë 07.10.2014, “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, për të lehtësuar ndjeshëm integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në ambientet e shkollave të zakonshme dhe mundësuar një arsimim shumë më cilësor për këta fëmijë, **është përcaktuar prania** dhe puna e mësuesit ndihmës, krahas mësuesit të klasës apo të lëndës.

Në këtë udhëzim, mësuesi ndihmës e sheh veten si pjesë të një ekipi, të përbërë nga mësuesi i klasës/lëndës, psikologu dhe prindi, që punon në bashkëpunim, duke shfrytëzuar të gjithë burimet dhe përvojën e krijuar në vite për të siguruar një arsim sa më cilësor për nxënësit me AK.

Nisur nga roli që duhet të luajë mësuesi ndihmës, në këtë udhëzim **janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes**, detyrat<sup>12</sup> e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar si dhe numri i mësuesve ndihmës në bazë të numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Në politikën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit objektiv kryesor është vendosja e mësuesve ndihmës në shkolla atje ku janë nxënësit me aftësi të kufizuar që kanë nevojë për këta mësues. Në vitin 2014 janë emëruar për herë të parë 65 mësues ndihmës në sistemin e arsimit parauniversitar publik dhe më pas ky numër paraqitet sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Tabela 7 “Mësues ndihmës në Institucionet Arsimore Parauniversitare publike dhe përqindja me aftësinë e kufizuar”.

DAR/ZA në vite	Publik- Gjithsej	Nga këto <sup>13</sup>				Nxënës me aftësi e kufizuar në vite	Raporti mësues ndihmës/ nxënës me aftësi të kufizuar
		Mësues ndihmës në arsimin bazë	Mësues ndihmës në arsimin e mesëm përgjithshëm	Mësues ndihmës në arsimin e mesëm të orientuar	Mësues ndihmës në arsimin parashkollor		
	1 = (2+3+4+5)	2	3	4	5	6	7 = 6/1
2014-15	65	-	-	-	-	3410	52.5
2015-16	113	-	-	-	-	3675	32.5
2016-17	310	-	-	-	-	3771	12.2
2017-18	585	-	-	-	-	4402	7.5
2018-19	933	915	18	0	0	4686	5.0
2019-20	1069	971	23	1	74	4768	4.5
2020-21	1176	1089	26	5	56	4672	4.0
2021-22	1408	1260	59	1	88	4507	3.2

Burimi i të dhënave – MAS


<sup>12</sup> Po sipas këtij Udhëzimi detyrat e përcaktuara në të për mësuesit ndihmës janë:

- ✓ Vlerëson aftësitë dhe kërkesat e fëmijës në procesin e shkollimit.
- ✓ Ndërton planin individual së bashku me aktorët e tjerë
- ✓ Bashkëpunon me prindërit dhe stafin pedagogjik për të ndjekur me kujdes ecurinë e fëmijës.
- ✓ Vlerëson aftësitë e fëmijës
- ✓ Ndërton mjete didaktike në përshtatje me nevojat e fëmijës
- ✓ Mban shënime dhe të dhëna për progresin e fëmijës
- ✓ Monitoron sjelljen e fëmijës dhe ndërton plan për ndërhyrje nëse e shikon të arsyeshme.
- ✓ Gjen aktivitete të ndryshme për tu mësuar aftësi fëmijëve si: (vizatimi, drama, etj.)
- ✓ Menaxhon krizat në klasë dhe zgjidh konfliktet.
- ✓ Përgatit nxënësit për kalimin në klasën pasardhëse.
- ✓ Informon prindërit rreth performancës dhe potencialeve të fëmijës.
- ✓ Bashkëpunon me stafin pedagogjik

<sup>13</sup> Deri në vitin 2018 numri i mësuesve ndihmës është mbajtur në total pasi ka qenë shumë i vogël.

Megjithëse vitet e fundit rezultojn një numër më i qëndrueshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuar, vihet re një rritje e numrit të mësuesve ndihmës ku ky raport nga 1 Mësues Ndhmës me 52.5 aftësi të kufizuar në vitin 2014 – 15, në vitin 2021 -22 është ulur në 3.2. Referuar zbatimit të Udhëzimit nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, përzgjedhja e mësuesve kryhet nga portali “Mësues për Shqipërinë”, ku zgjidhen kandidatët që kanë përfunduar studimet për arsim special dhe në mungesë të tyre mësues që disponojnë certifikata të trajnimeve për fëmijët me aftësi të kufizuar. Duke filluar nga nëntori 2019, profili i mësuesit të arsimit special është shtuar në listën e profesioneve të rregulluara dhe janë licencuar mësuesit e parë në këtë profil, të cilët kanë përparësi në emërimet si mësues ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara në shkolla jo speciale.

Grafiku 15 Raporti mësues ndihmës/nxënës me AK



Burimi i të dhënave – MAS

Institucionet arsimore planifikojnë zhvillimin profesional të mësuesve, sipas nevojave të tyre dhe në përputhje me politikat arsimore qendrore, vendore dhe të institucionit.

Format e zhvillimit profesional janë: zhvillimi i brendshëm profesional, trajnimet, rrjetet profesionale, këshillimet, kurset afatshkurtra dhe ato afatgjata.


Mësuesit dhe drejtorët duhet të trajnohen të paktën 3 ditë në vit.

Trajnimet duhet të zhvillohen sipas sistemit "kërkesë - ofertë", në bazë të kërkesave nga institucionet arsimore dhe të ofertave nga agjenci trajnuese që mund të jenë publike ose private. Programet trajnuese akreditohen nga ministria ndërsa njësitë arsimore vendore organizojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve, në bashkëpunim me agjenci trajnuese, me programe trajnimi të akredituara, të përzgjedhura me konkurrencë të hapur, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit.

Burimet financiare për trajnimet janë nga kontributi vetjak i punonjësit arsimor, Buxheti i Shtetit, projekte të organizatave jofitimprurëse, të fondacioneve, të institucioneve, vendase ose të huaja, dhe burime të tjera të ligjshme.

Kategoritë e kualifikimit të mësuesve janë tri konkretisht: "Mësues i kualifikuar"; "Mësues specialist"; "Mësues mjeshër". Rritja në kategori e mësuesit bëhet nëpërmjet përvijës, trajnimit dhe pasi të ketë dhënë me sukses provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit.

Grafiku 16 Mësues ndihmës sipas kategorive



*Burimi i të dhënave – MAS*

Sipas grafikëve 15 dhe 16 në lidhje me raportin mësues ndihmës/ nxënës me aftësi të kufizuar rezultojnë se nga 1523 mësues ndihmës, 60.67% e tyre janë mësues të kategorisë së katërt.

Pjesa më e madhe e mësuesve ndihmës nuk janë të profilit “Arsim special”, por vijnë nga profile të ndryshme nga portali “Mësues për Shqipërinë”, pasi numri i mësuesve me profilin “Arsim special” të cilët kanë aplikuar në portal ka qenë shumë i ulët në raport me nevojat. Janë ngritur dhe funksionojnë gjithashtu dhe rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës, në përmbushje të nevojave të tyre, por nga intervistat në terren u konstatua se ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të rrjeteve të mësuesve ndihmës bëhet e vështirë pasi këta drejtues ndërrohen/zëvendësohen shpesh.


Sipas Udhëzimit nr.1, datë 20.01.2017. “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, një nga format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë janë rrjetet profesionale. Rrjetet profesionale kanë për qëllim zhvillimin profesional të punonjësve të institucioneve arsimore përmes:

Informimit dhe këshillimit në lidhje me risitë dhe zhvillimet në fushën e reformave në arsimin parauniversitar; Trajnimit të pjesëtarëve të rrjetit në lidhje me tematika që dalin si nevoja të

tyre; Shkëmbimit të eksperiencave pozitive dhe të suksesshme mes pjesëmarrësve në rrjet për tematika të punës së tyre të përditshme; Shkëmbimit në internet të përvojave, mendimeve, pyetjeve dhe përgjigjeve që mbështesin zhvillimin profesional, etj.

Mësuesit ndihmës sipas titujve të diplomës paraqiten grafikisht bashkëlidhur.


*Grafiku nr.17, Mësuesit ndihmës sipas profesionit*



Burimi i të dhënave Raporti i MAS

Përsa më lartë, me arsim special janë vetëm 31 nga 1523 mësues ndihmës. Ndërkohë nga të dhënat e marra nga DRAP<sup>et</sup> nga grupi i auditimit, numri i mësuesve me arsim special është 71. Pra, rezulton mos rakordim shifrash ndërmjet DRAP<sup>ve</sup> dhe MAS në lidhje me numrin e mësuesve ndihmës me arsim special.

Nga këta 1119 mësues ndihmës janë të trajnuar për nxënësit me aftësi të kufizuara ndërsa 404 mësues ndihmës janë të pa trajnuar, që përbëjnë 27% të numrit total të tyre.



Grafiku 18, Vjetërsia në punë e mësuesve ndihmës

Nga auditimi i vjetërsisë në punë e mësuesve ndihmës rezulton se 55% e tyre kanë vjetërsi 0 – 5 vjet pune.

Burimi i të dhënave Raporti i MAS

### **Vlerësimi i nevojave për zhvillim profesional të mësuesve ndihmës (MN) në arsimin parauniversitar.**

Me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara duhet të hartohen programe trajnimi për mësuesit ndihmës për edukimin e tyre në vazhdim. Veprimtaritë për mbështetjen e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë duke përfshirë edhe mësuesit ndihmës, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, i zhvillon kryesisht bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit

të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. Sipas këtij Udhëzimi forma kryesore e trajnimit për zhvillim profesional në nivel lokal e punonjësve arsimorë janë rrjetet profesionale. Ato ngrihen në çdo Zyrë Vendore Arsimore Parauniversitare, nën monitorimin e tyre dhe përfshijnë të gjithë punonjësit arsimor të ndarë sipas fushave kurrikulare apo fushave të mësimdhënies. Rrjeti profesional drejtohet nga një mësues me eksperiencë dhe që ka treguar aftësi organizative dhe trajnuese.

Gjatë periudhës maj - korrik 2021 është zhvilluar trajnimi i rreth 700 drejtuesve të rrjeteve profesionale (në raport me rreth 1,100 drejtues rrjetesh gjithsej) në arsimin parauniversitar në çdo Zyrë Vendore Arsimore Parauniversitare të vendit. Drejtuesit e rrjeteve të përfshirë në trajnim janë të të gjithë cikleve dhe lëndëve në arsimin parauniversitar. Trajnimet zhvillohen në ambientet shkollore pranë ZVAP.

Për periudhën 2019 - 6 muaji i parë 2022, asnjë nga DRAP-et nuk zotëronin të dhëna në lidhje me aftësinë e kufizuar nga ZVA përkatëse. Këto të dhëna u grumbulluan prej tyre vetëm pas paraqitjes së pyetësorëve të grupit të auditimit të KLSH, të cilat në disa raste ishin të paplota.

Mos evidentimi i të dhënave ndikon në planifikimin e saktë të nevojave për mësues ndihmës dhe arsimin special si dhe në monitorimin e punës së tyre.

Konkretisht të dhënat e paraqitura me pyetësorët nga DRAP-et , paraqiten sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Tabela "Të dhënat në total të 4 DRAP-ve sipas pyetësorëve të grupit të Auditimit të KLSH.

Vitet	DREJTORIT E RAJONALE T E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR																													
	I/1 Fëmijë te evidentuar 6-19 vjeç		I/2 Fëmijë me AK që kanë ndjekur nivele te ndryshme te arsimit PU		I/2 FAK që asistohen në ambientet e shtëpive të tyre nga mësuesit mbështetës		I/2 FAK në moshë për ndjekjen e arsimit parauniversitar, por nuk janë të përfshirë në arsim		I/4 Braktisje te vitit ushtrimor		I/5 Vlerësimi i progresit të secilit prej nxënësve me AK në raporte		I/6 FAK të vlerësuar nga Komisionet Multidisiplinare		I/7 FAK që kanë kaluar nga arsimit publik në arsimin privat		I/8 Rolin e mësuesit ndihmës e luan prindi		I/9 FAK në shkolla me klasa kolektive		I/10 Shkolla në juridiksionin		I/13 Prindër të FAK që janë të angazhuar në këshillat e prindërve		Nr. Nxënës AK që nuk vijojnë arsimin		FAK kanë kaluar nga frekuentimi i arsimit të zakonshëm në arsim special		IV/1 nuk është pranuar nga prindi apo kujdestari përgjegjës rekomandimi i komisionit Multidisiplinar për trajtim të fëmijës me program të veçantë individual apo për trajtimin në shkolla speciale?	
	Arsimi bazë	Arsimi mesëm	Total	Femra	Total	Femra	Total	Femra	Total	Femra	arsimin special	arsimin e zakonshëm	1/7 FAK që kanë kaluar nga arsimit publik në arsimin privat	1/8 Rolin e mësuesit ndihmës e luan prindi	1/9 FAK në shkolla me klasa kolektive	Total	Të aksesueshme	1/13 Prindër të FAK që janë të angazhuar në këshillat e prindërve	Nr. Nxënës AK që nuk vijojnë arsimin	FAK kanë kaluar nga frekuentimi i arsimit të zakonshëm në arsim special	IV/1 nuk është pranuar nga prindi apo kujdestari përgjegjës rekomandimi i komisionit Multidisiplinar për trajtim të fëmijës me program të veçantë individual apo për trajtimin në shkolla speciale?									
<b>2019-20</b>	2667	1940	108	34	8	1	0	2203	78	2550	806	74	46	624	525	160	8	9	108											
<b>2020-21</b>	2888	2151	126	14	5	3	0	2297	12	2779	824	66	56	656	488	135	5	11	77											
<b>2021-22</b>	3020 <sup>14</sup>	2182	143 <sup>15 16</sup>	18 <sup>17</sup>	7	5 <sup>18</sup>	2 <sup>19</sup>	2497	62 <sup>20</sup>	2914	853	69 <sup>21</sup>	62 <sup>22</sup>	662 <sup>23</sup>	527 <sup>24</sup>	182 <sup>25</sup>	7	22 <sup>26</sup>	63 <sup>27</sup>											

Burimi i të dhënave: Plotësimi i pyetësorëve nga DRAP-et.

Shënim: të dhënat sipas DRAP-eve paraqiten në Aneksin nr.4.1 "Të dhëna nga pyetësi i plotësuar nga DRAP-et"

<sup>14</sup> Nga DRAP Lezhë nuk e kanë deklaruar

<sup>15</sup> DRAP Korçë, nuk i ka sjellë të dhënat sipas arsimit bazë dhe atij të mesëm.

<sup>16</sup> Nga DRAP Fier, pavarësisht pyetësorit nuk janë raportuar të ndarë sipas kategorisë

<sup>17</sup> Nga DRAP Fier deklarohet se ZVAP-et nuk disponojnë të dhëna në lidhje me asistimin e fëmijëve në shtëpi.

<sup>18</sup> DRAP Fier dhe Lezhë nuk e kanë deklaruar

<sup>19</sup> DRAP Durrës nuk ka dhënë përgjigje

<sup>20</sup> DRAP Fier dhe Lezhë pavarësisht pyetësorit nuk janë raportuar të ndarë sipas kategorisë.

<sup>21</sup> DRAP Lezhë nuk ka paraqitur të dhëna

<sup>22</sup> DRAP Lezhë nuk ka paraqitur të dhëna

<sup>23</sup> DRAP Lezhë nuk ka paraqitur të dhëna

<sup>24</sup> DRAP Lezhë nuk i ka përcaktuar se në çfarë viti

<sup>25</sup> DRAP Lezhë nuk ka paraqitur të dhëna.

<sup>26</sup> DRAP Fier, pavarësisht pyetësorit nuk është përgjigjur

<sup>27</sup> DRAP Lezhë nuk ka paraqitur të dhëna.

Referuar të dhënave nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, (plotësim i pyetësorit) gjatë vitit arsimor **2020-2021 janë trajnuar rreth 47 drejtues rrjetesh** profesionale të mësuesve ndihmës në të gjithë ZVAP-të e vendit. Për shkak të pandemisë Covid-19, trajnimi është realizuar on-line nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve. *(Një drejtues rrjeti drejton dhe trajnon rreth 20-25 mësues ndihmës përmes takimeve/trajnimeve të përmuajshme. Kjo do të thotë se trajnimi ka zbritur tek rreth 1000 mësues ndihmës në AP).*

Fokus i trajnimit ka qenë:


- Baza ligjore lidhur me mësuesit ndihmës dhe zbatimi i saj;
- Funksionimi i rrjetit profesional dhe përgjegjësitë e tij në procesin e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës;
- Planifikimi vjetor i punës së rrjetit si dhe monitorimi e raportimi i punës së rrjetit.

Gjatë vitit **2022 janë trajnuar rreth 50 drejtues të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës** dhe rreth 180 mësues ndihmës anëtarë të rrjeteve profesionale. *(Një drejtues rrjeti drejton dhe trajnon rreth 20-25 mësues ndihmës përmes takimeve/trajnimeve të përmuajshme. Kjo do të thotë se trajnimi ka zbritur tek rreth 1200 mësues ndihmës në AP).*

Trajnimet janë realizuar drejtpërdrejtë në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, Lezhë, Korçë, Durrës dhe ZVAP Tiranë. Ai është mundësuar nga bashkëpunëtorë të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar të identifikuar si ekspertë në fushën e pedagogjisë speciale. Fokus i trajnimit ka qenë: Hartimi i planit PEI; Vlerësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara; përgatitja dhe përdorimi i mjeteve didaktike efektive në procesin e edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- Grupi i auditimit, referuar Udhëzimit të MAS, nr.16, datë 28.07.2021 “*Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë*”, Kreu I, neni 6, pika 1, 2, 3 për "Kreditet", vlerësoi punën e kryer për trajnimet e MN, sipas të dhënave të grumbulluara nga DRAP-et. Këto të dhëna paraqiten sipas aneksit nr.4.3.1, bashkëlidhur shtojcave dhe grafikut sa më poshtë vijon:


Grafiku 19, “Grafiku mbi nivelin e trajnimeve sipas viteve dhe DRAP për



MN”

Burimi: DRAP-et

Grafiku 20, MN të trajnuar ndaj totalit të mësuesve ndihmës sipas DRAP-ëve dhe viteve.



Burimi: DRAP-et

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar me mbështetjen e UNDP, në kuadër të programit “Askush të mos mbetet pas”, ka ndërmarrë një proces të identifikimit të nevojave të mësuesve ndihmës në të gjitha ZVAP-të e vendit. Ky proces i identifikimit dhe analizës së nevojave përfaqëson hapin e parë të vendimmarrjeve të mëtejshme apo ndërhyrjeve të nevojshme. Ai u mundësua përmes aplikimit on-line të një instrumenti të detajuar, i cili u vu në dispozicion të të gjithë mësuesve ndihmës që punojnë aktualisht në sistemin arsimor parauniversitar. Analiza e të dhënave të grumbulluara, që paraqitet më poshtë, paraqet përmbledhtas të dhëna mbi gjendjen reale të aftësive, përvojave të grumbulluara dhe nevojave më të rëndësishme të këtij grupi.

- Pjesa më e madhe e MN (rreth 60% e tyre) punojnë dhe mbështesin 1-2 fëmijë me aftësi të kufizuara; Rreth 25% e mësuesve ndihmës mbështesin dhe punojnë me më shumë se tre fëmijë me aftësi të kufizuara.

- Gati 50% e mësuesve ndihmës janë të rinj në këtë pozicion, me një eksperiencë deri në 3 vite si mësues ndihmës; Pothuajse të gjithë mësuesit ndihmës punojnë në arsimin e detyruar. Pothuajse të gjithë mësuesit ndihmës janë femra.

- Format më të frekuentuara të trajnimit janë takimet e rrjeteve profesionale dhe takimet e shkëmbimet më mësues të tjerë të së njëjtës shkollë. Gjithashtu ato ndjekin trajnime të akredituara të ofruara nga agjenci që janë akredituara nga MAS.

- MN vlerësojnë si një institucion të rëndësishëm komisionin e shkollës për fëmijët me aftësi të kufizuar, i cili mundëson orët e nevojshme për të mbështetur fëmijën dhe planifikimin e veprimtarive edukative për të.

- MN e shohin bashkëpunimin me mësuesin e klasës me një rëndësi të veçantë në hartimin e PEI-it dhe vlerësimin e nxënësit me aftësi të kufizuar sipas nivelit të arritjeve të fushave të zhvillimit. Gjithashtu, bashkëpunimi me prindërit e fëmijës me aftësi të kufizuar, konsiderohet nga mësuesit ndihmës si faktor i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit dhe progresit të fëmijës.

- Nevoja për trajnim dhe aftësim profesional e MN fokusohet në një sërë tematikash si: Metoda dhe strategji të mbështetjes në klasë të fëmijëve me aftësi të kufizuar; Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë për të mbështetur fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuar; Dokumentacioni i nevojshëm që mban MN; Hartimi i programeve edukative individuale (PEI) efektiv; Karakteristikat kryesore (format e manifestimit) të llojeve të ndryshme të paaftësive; etj.<sup>28</sup>

- Për trajnimet e punonjësve arsimore në fushën e gjithëpërfshirjes nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar nuk është harxhuar buxhet nga fondi i trajnimeve.

Nga auditimi rezultoi se ekzistojnë mësues ndihmës të pakualifikuar në fushën e pedagogjisë speciale, fakt i cili e vështirëson mbështetjen në cilësinë e duhur të edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të rrjeteve të mësuesve ndihmës bëhet e vështirë në rastet kur këto drejtues ndërrohen/zëvendësohen shpesh dhe investimi i nisur përmes trajnimeve të tyre bëhet i vështirë.

Nga ana e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, nuk ka të dhëna për evidentimin nëse nga ana e drejtuesve të rrjeteve profesionale është përcjellë trajnimi i marrë tek mësuesit ndihmës anëtarë të rrjetit përmes takimeve të përmuajshme që realizojnë gjatë një viti mësimor.

Nuk disponohet nga ana e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar raport të dhënash për numrin e mësuesve ndihmës të trajnuar nga agjencitë e akredituara.

Nga intervistat, verifikimet e takimet me mësuesit ndihmës në terren grupi i auditimit në lidhje me trajnimin e tyre konstatoi se:

- Trajnimi nuk ka qenë i disponueshëm në nivel lokal;
- Mësuesit nuk kanë pasur mundësi financiare për të mbuluar trajnimin;
- Trajnimet janë zhvilluar brenda orarit mësimor dhe mësuesi ndihmës nuk mund të marrë leje për të marrë pjesë në të;
- Ka raste kur trajnimi bëhet pas orarit të mësimin dhe mësuesi nuk mundet të shkojë;

Ndërsa në shumë pak raste mësuesit ndihmës bashkëpunojnë me partnerë të tjerë të specializuar për fëmijët me aftësi të kufizuar, brenda komunitetit si dhe shumë pak bashkëpunohet me qendrat e shërbimit social për të përfutur profesionalisht prej tyre.

Në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar ka mungesë të trajnimeve në një masë të konsiderueshme të mësuesve ndihmës. Nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në

---

28 Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga MAS për mësuesit ndihmës. Raportet

Arsimin Parauniversitar nuk është bërë evidentimi i mësuesve ndihmës që nuk kanë plotësuar kreditet e duhura gjatë vitit dhe më pas kryerjen e trajnimeve të specializuara dhe të vërtetuara ato me anë të certifikatave.

#### **Gjetje nga auditimi:**

**10.** Nga auditimi u konstatua se :

- nuk ka një ndarje të numrit të mësuesve ndihmës pjesëmarrës në trajnime sipas cikleve,
- ekzistojnë mësues ndihmës të pakualifikuar në fushën e pedagogjisë speciale,
- ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të rrjeteve të mësuesve ndihmës bëhet e vështirë sepse këto drejtues ndërrohen/zëvendësohen shpesh dhe investimi i nisur përmes trajnimeve të tyre bëhet i vështirë,
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar nuk ka raport të dhënash për numrin e mësuesve ndihmës të trajnuar nga agjencitë e akredituara, gjithashtu:
  - trajnimi nuk ka qenë i disponueshëm në nivel lokal;
  - mësuesit nuk kanë pasur mundësi financiare për të mbuluar trajnimin;
  - trajnimet janë zhvilluar brenda orarit mësimor dhe mësuesi ndihmës nuk mund të marrë leje për të marrë pjesë në të;

#### **Konkluzion:**

**10.** Planifikimi dhe zhvillimi i trajnimeve të aftësimit profesional sipas nevojave të mësuesve dhe cikleve, kryerja e trajnimeve të specializuara dhe certifikimi i tyre nëpërmjet diplomave, mundëson për një zhvillim profesional të lartë të mësuesve ndihmës i cili është shumë i nevojshëm prej nga varet përmirësimi dhe progresi i çdo fëmije me aftësi të kufizuar për mësimin dhe edukimin e tyre.

#### **Rekomandimi:**

**10.1-** Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, të marrë masa për trajnimin e mësuesve sipas zonave, evidentimin e përcjelljes së trajnimit nga drejtuesit e rrjeteve profesionale tek mësuesit ndihmës, trajnimet të mos realizohen gjatë procesit mësimor si dhe ngritja e kapaciteteve të mos cenohet nga lëvizjet e shpeshta dhe të pa justifikuara.

**Në vijimësi**

#### **Gjetje nga auditimi:**

**11.** Në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar ka mungesë të trajnimeve në një masë të konsiderueshme të mësuesve ndihmës. Nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar nuk është bërë evidentimi i mësuesve ndihmës që nuk kanë plotësuar kreditet e duhura gjatë vitit dhe më pas kryerjen e trajnimeve të specializuara dhe të vërtetuara ato me anë të certifikatave.

#### **Konkluzion:**

**11-** Trajnimi dhe aftësimi profesional i mësuesve ndihmës është shumë i nevojshëm. Mos evidentimi i të dhënave nuk mundëson një planifikim të duhur të trajnimeve sipas nevojave të mësuesve. Moskryerja e trajnimeve të specializuara dhe të vërtetuara ato me anë të certifikatave apo diplomave, për trajtimin dhe edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuar tregon për një zhvillim profesional të ulët të mësuesve ndihmës prej nga varet përmirësimi dhe progresi i çdo fëmije me aftësi të kufizuar.

#### **Rekomandime:**

**11.1-**Nga ana e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar të merren masa për evidentimin e përcjelljes së trajnimit të marrë nga drejtuesit e rrjeteve profesionale tek mësuesit ndihmës anëtarë të rrjetit, përmes takimeve të përmuajshme që realizojnë gjatë një viti mësimor.

**Në vijimësi**

**11.2-** Nga ana Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar të merren masa për trajnime të strukturuar dhe me shkëmbim eksperiencash dhe përvojash, të cilat të realizohen mundësisht gjatë periudhës kur nuk ka proces mësimor.

**Në vijimësi**

**11.3-** Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar të bëjë kujdes që investimi i realizuar për ngritjen e kapaciteteve për kualifikimin e drejtuesve të rrjeteve të mësuesve ndihmës, të mos çenohet nga zëvendësimet e shpeshta dhe të pa justifikuar.

**Në vijimësi**

**11.4-** Me qëllim që të sigurohet një arsimim sa më cilësor për fëmijët më Aftësi të Kufizuar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, të investojë në programe orientuese për fëmijët me aftësi të kufizuar si dhe të marrë masat për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mësuesve ndihmës si rol thelbësor në suksesin e shkollave gjithëpërfshirëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **Gjetje nga auditimi:**

**12.** Numri i ulët në rang kombëtar i mësuesve me arsim special të cilët aplikojnë për këtë pozicion nëpërmjet portalit *Mësues për Shqipërinë.al* sjell si pasojë emërimin e mësuesve ndihmës me kontratë sezonale, gjë që krijon probleme, pasi procedura e përzgjedhjes së tyre në portal shpesh herë vonohet duke bërë që në fillim të vitit të ri shkollor ata të mos jenë të pranishëm që në ditën e parë. Edhe në rastet kur mësuesi ndihmës e ndërpret mësimdhënien për shkaqe të ndryshme, procedura e përzgjedhjes së një mësuesi tjetër sërish krijon vonesa<sup>29</sup>.

### **Konkluzioni.**

**12.** Mos emërimi i mësuesve definitive apo dhe me kontratë pa afat sipas procedurave dhe afateve ligjore, sjell pasoja tek nxënësit me aftësi të kufizuar, duke mos u dhënë atyre mundësinë e fillimit të shkollës në të njëjtën kohë me fëmijët e tjerë. Kjo gjë shkakton probleme dhe vështirësi për këto fëmijë duke filluar nga mos përshtatja e tyre në mësim, paralel me nxënësit e tjerë, deri të krijimi i një klime diskriminimi që i bën ata të ndjehen të përjashtuar ndërkohë që duhet të jenë të barabartë mes të barabartëve.

### **Rekomandim:**

**12.1-** Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, të merren të gjitha masat për emërimin dhe punësimin e mësuesve ndihmës me kontrata të përhershme, si në fillimin e vitit shkollor ashtu edhe për rastet e zëvendësimit të tyre gjatë vitit, në mënyrë që mos të ketë në asnjë rast arsye të ndërprerjes të mësimin për fëmijët me aftësi të kufizuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **Gjetje nga auditimi:**

**13.** Ndjekja e arsimit të zakonshëm me mësues mbështetës për diagnoza të veçanta si, dëmtim të shikimit apo dëgjimit, nuk ka qenë efektive, pasi mësuesit nuk janë të trajnuar dhe nuk përmbushen nevojat e fëmijës për përdorimin e gjuhës së shenjave apo alfabetit BRAIL.

-Gjithashtu nga intervistat u konstatua se prindërit e fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe shikojnë të cilët ndjekin arsimin special, nuk njohin gjuhën e shenjave apo alfabetin BRAIL, por kanë përshtatur shenja personale të lindura nga nevoja gjatë viteve.

### **Konkluzion:**

**13.** Mos trajnimi i mësuesve si dhe aftësimi i prindërve sjell që fëmijët të jenë të dyzuar për aftësitë e fituara në shkolla.

### **Rekomandim:**

<sup>29</sup> Referuar përcaktimeve në Udhëzimin nr. 26 datë, 25.11.2019, Kreu 1, "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së mësuesve ndihmës".

**13.1-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, të marrin masa për krijimin e kurseve të plota vjetore për trajnimin e mësuesve si dhe të prindërve për gjuhën e shenjave apo alfabetin BRAIL.

**Gjatë vitit 2023**

### **Gjetje nga auditimi:**

**13.** Në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar janë emëruar në një masë të konsiderueshme mësues ndihmës të profileve të ndryshme (*kontrata me emërim me afat/kontrata pa afat, si dhe të emëruar në mënyrë definitive*). Emërimi i tyre është bërë pa pasur të plotësuar kriterin<sup>30</sup>, për kryerjen trajnimeve të specializuara dhe të vërtetuara ato me anë të certifikatave apo diplomave, për trajtimin dhe edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

### **Konkluzion:**

**13.** Numri shumë i ulët i mësuesve ndihmës me arsim special në arsimin gjithëpërfshirës në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar si dhe përzgjedhja e mësuesve ndihmës me profile të ndryshme që nuk plotësojnë kriteret, sjellin vështirësi nga ana e mësuesve ndihmës në zbatimin e kërkesave të edukimit gjithëpërfshirës, apo të kuptimit të procesit të hapave të cilat duhet të ndjekin në interes të arritjes së objektivit.

### **Rekomandim:**

**13.1-** Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në rastet e përzgjedhjes së mësuesve ndihmës të cilët nuk plotësojnë kriterin e të pasurit “Arsim Special” të përzgjedhë ata mësues të cilët kanë kryer trajnime të specializuara të vërtetuara me anë të certifikatave apo diplomave, për trajtimin dhe edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **4.3.2 A janë ndërmarrë masa për plotësimin e nevojave aftësuese nëpërmjet funksionimit të Komisioneve Multidisiplinare, hartimit të programeve edukuese individuale dhe monitorimit të ecurisë së tyre në kuadrin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës e special?**

Referuar ligjit nr. 69/2012, datë 22.06.2012, “Për sistemin arsimorë parauniversitar në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar, rregullores për funksionimin e institucioneve Arsimore Parauniversitar, kreu IV, neni 80, pika 1<sup>31</sup> përcaktohet ngritja e komisionit në ZVA dhe detyrat e tij. Komisioni Multidisiplinar (KMD) për AK pranë ZVAP ngrihet, funksionon dhe zbaton detyrimet që i ngarkohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimimin e fëmijëve me AK. Kryetar i KMD, është drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social pranë ZVAP, ndërsa anëtar janë një psikolog nga njësia, një punonjës social nga njësia, një mësues (*kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar*) dhe një mjekë pediatër (*kur është e mundur, mjekë pediatër zhvillimi*).

Komisioni duhet të mbledhet të paktën tre herë gjatë çdo viti shkollor (*para fillimit të vitit shkollor, në fund të periudhës së parë dhe në fund të vitit mësimor*) me kohëzgjatje në varësi

<sup>30</sup> sipas nenit 6, pika 1, 2, dhe 3 të Udhëzimit nr. 16, datë 28.07.2021 “Për Organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”

<sup>31</sup> Neni 80 Ngritja e komisionit në ZVA dhe detyra të tij

2. ZVA, në bazë të numrit të IA-ve që mbulon dhe në bazë të numrit të nxënësve me AK, mund të ngrëjë me shumë se një komision për mbulimin në kohë të nevojave për vlerësim.

3. Komisioni, me kërkesën e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës, ose të drejtorit të IA-së, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij.

5. Drejtori i IA-së këshillohet me komisionin e institucionit, para se t’i drejtohet komisionit në ZVA, dhe bashkëpunon me personin që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij.

6. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore i paraqet ZVA-së raportin vlerësues të fëmijës së tij të kryer nga komisioni mjekësor, kur fëmija është vlerësuar nga ky komision mjekësor.

7. Komisioni: a) njofton personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës;

b) i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar, ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas;

c) rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese;

e) rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjekoligjor kur fëmija nuk e ka.

të numrit të fëmijëve të cilët duhet vlerësuar, për çdo fazë vlerësimi për kryerjen e veprimtarive për mbulimin në kohë të nevojave për vlerësim si:

- Planifikimin e veprimtarisë vlerësuese të Komisioni Multidisiplinar për AK.
- Shqyrtimin e kërkesave të sjella nga IA dhe nga prindërit e fëmijëve më AK të paktën dy javë para fillimit të procesit të vlerësimit, sipas njoftimit për fillimin e procesit nga ZVAP.
- Informimin e IA për grafikun e vlerësimit të nxënësve (datën, orën dhe vendin), pas shqyrtimit të kërkesave dhe dokumentacionit përkatës.
- Vlerësimin dhe rivlerësimin e nevojave dhe ecurisë së fëmijës me AK dhe del me rekomandime përkatëse mbi: llojin e arsimit që do të ndjekë nxënësi, nevojën për mësuës ndihmës, orët përkatëse, nivelin e arritjeve mësimore dhe sjellore të PEI-t dhe shërbime të tjera që mund ti ofrohen fëmijës brenda dhe jashtë IA.

KMD duhet të mblidhet edhe për vlerësimin e rasteve urgjente, sipas kërkesës së IA ose të prindërve. KMD në përfundim të çdo faze të vlerësimit i përcjell ZVAP rekomandimet me orët e caktuara për çdo fëmijë, në fund të procesit të vlerësimit.

Për një numër fëmijësh të cilët paraqiten në Komisionet Multidisiplinare me diagnoza të rënda ose kanë disa diagnoza bashkë shoqëruese, krahas nevojave për mësuës ndihmës, nga Institucionet Arsimore Parauniversitare vlerësohen edhe nevoja të tjera përkujdesje (*si, shoqërimi në tualet, higjienizimi, ushqimi gjatë qëndrimit në shkollë, etj.*) por, në detyrat e Komisionit Multidisiplinar nuk parashikohet rekomandimi i personave për përkujdesje, por vetëm i mësuësve për nevoja mësimore dhe/ose sjellore.<sup>32</sup>

Vlerësimi dhe praktika e punës së komisionit duhet të mbështetet në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit.

Gjatë vlerësimit të fëmijës komisioni fton të paktën një prind dhe po të jetë e nevojshme, të afërm të tij. Kur fëmija është në kopsht/shkollë, përveç personit që ushtron përgjegjësinë prindërore marrin pjesë: punonjësi i shërbimit psiko-social në IA, mësuës të fëmijës të caktuar nga drejtori i IA-së. Komisioni rekomandon ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur gjykon se ndjekja e një shkolle të zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën AK.

Ai duhet të njoftojë me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale, si dhe **rekomandon mjetet ndihmëse që i nevojiten fëmijës për të realizuar procesin mësimor-edukativ.**

Gjithashtu komisioni i ZVA-së udhëzon komisionet e IA-ve për punën me nxënësit me AK.

Janë ZVA ato që duhet të sigurojnë kushtet e përshtatshme për ushtrimin e punës së komisionit dhe t'u venë në dispozicion dokumentacionin e fëmijëve që do të vlerësojnë, të paktën dy javë para vlerësimit.

Duhet të mbajnë dokumentacionin e gjendjes fillestare të fëmijës me AK dhe të përditësojë ecurinë e tij në bashkëpunim me komisionin në IA.

Për nxënësit që vlerësohen për herë të parë nga komisioni nevojat vlerësohen nëpërmjet një formati vlerësimi të nevojave arsimore, sociale dhe një vlerësimi gjithanshëm i fushave të zhvillimit. Format i është një ndërthurje e ICF CHECKLIST dhe vlerësimit bazuar mbi fushat e zhvillimit, ndërthurur dhe me vlerësimin e nevojave arsimore.

Për nxënësit që rivlerësohen periodikisht, çdo vit shkollor, ose sipas nevojave, aplikohet një format rivlerësimi në të cilën vlerësohet ecuria e nxënësve në bazë të arritjeve të pritshme të përcaktuara në planin Edukativ Individual dhe nevojave që nxënësi mund të shfaq vit pas viti. Një rol kyç për gjithëpërfshirjes e nxënësve me aftësi të kufizuar në sistemin arsimor, luajnë dhe komisionet e AK në shkollë<sup>33</sup>, të cilët kanë si kryetarë psikologët e shkollave. Në mënyrë të vazhdueshme janë dhënë udhëzime që komisionet e shkollave të trajnojnë stafet dhe

<sup>32</sup> MASHT. (2019), Prishtinë Udhëzues për planifikim dhe raportim të punës së edukatoreve, mësuësve mbështetës si dhe asistentëve-Përgjegjës të asistentit-es për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

<sup>33</sup> Neni 83 “Komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm” i rregullores për funksionimin e institucioneve Arsimore Parauniversitar

zhvillojnë tema ndërgjegjësimi apo aktiviteteve në të cilat nxënësit me aftësi të kufizuara janë në bashkëveprim me bashkëmoshatarët. Janë trajnuar mësues të me qëllim bashkëpunimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara, njohja me diagnozat më të hasura në shkolla, metoda efektive mësimdhënie për nxënësit me AK, koordinimi i punës ndërmjet mësuesit të klasës dhe mësuesit mbështetës, përfshirja e nxënësve me AK në aktivitete shkollore.

Viti shkollor 2019-2020 e përballi sistemin arsimor parauniversitar me sfida të reja të panjohura, të cilat e detyruan që të ndryshonte në tërësi mënyrat e mëparshme të funksionimit, si pasojë e pandemisë Covid-19 e cila ndryshoi edhe mënyrën se si KMD funksionoi këtë vit shkollor. Procesi i rivlerësimit të nxënësve në qershor 2020 është kryer përmes dosjeve pa prezencën e nxënësve në komision.

Gjatë procesit të vlerësimit KMD shqyrton dosjen e nxënësit të paraqitur nga shkolla, e cila në përmbajtje të saj ka raportin mjekësor (KML ose KMCAP) brenda afateve të vlefshmërisë ligjore, vlerësimin nga punonjësi i shërbimit psiko-social në shkollë (psikologu ose punonjësi social), kopje të Planit Edukativ Individual të hartuar sipas udhëzimeve të KMD, vlerësimin e ecurisë për çdo periudhë nga komisioni i shkollës për AK.

Gjatë procesit të vlerësimit të nxënësit me AK duhet të jetë i pranishëm prindi, mësuesi ndihmës dhe punonjësi i shërbimit psiko-social.

Nga vlerësimet dhe rivlerësimet e nxënësve me AK gjatë tre viteve të fundit shkollore në subjektet objekt auditimi u vu re:

- Rritja e numrit të kërkesave për vlerësim të nxënësve nga ana e institucioneve arsimore
- Rritja e numrit të kërkesave për vlerësim të nxënësve nga ana e prindërve
- Tendencë në rritje për diagnostikimin e problematikave të zhvillimit për përfitimin e mësuesit ndihmës.
- Rritja e numrit të orëve të asistimit të nxënësve me nevoja të veçanta nga mësues ndihmës, ka sjellë për rrjedhojë rezultate më të mira të të nxënësve.
- Rritja e numrit të fëmijëve me AK të vlerësuar nga Komisioni dhe rritja e orëve të rekomanduara bazuara në nevojat e nxënësve ka sjellë rritjen e numrit të mësuesve ndihmës.
- Rritja e bashkëpunimit shkollë – prind si një marrëdhënie e domosdoshme për ecurinë e nxënësve me nevoja të veçanta.

Komisionet Multidisiplinare (KMD) të vlerësimit të nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në çdo rast, në të gjitha Zyrat Vendore Arsimore nuk kanë arritur të bëjnë vlerësimin sipas ICF Checklist të miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë<sup>34</sup>, por Komisionet Multidisiplinare përdorin një model tjetër vlerësimi shumë të reduktuar, i hartuar nga vetë ata dhe e pa miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

- Për nxënësit që paraqiten për herë të parë në Komisionet Multidisiplinare vlerësimi bëhet nëpërmjet një ndërthurje të ICF Checklist dhe vlerësimit të përshtatur bazuar mbi fushat e zhvillimit, ndërthurur me vlerësimin e nevojave arsimore, duke mos arritur të vlerësojnë plotësisht nevojat e tyre.

Ndërsa për nxënësit që rivlerësohen periodikisht, çdo vit shkollor, ose sipas nevojave, aplikohet një format rivlerësimi në bazë të arritjeve të pritshme të përcaktuara në Planin Edukativ Individual dhe nevojave që nxënësi mund të shfaq vit pas viti, por kjo është e pa unifikuar në nivel Republike dhe e pa monitoruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

Praktika e punës e përdorur nga Komisionet Multidisiplinare në të cilën vlerësohen nevojat arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara, nëpërmjet *Checklistës* shumë të reduktuar dhe të

---

<sup>34</sup> standarde të Organizatës Botërore të Shëndetësisë

pa miratuar, riskon evidentimin e saktë e për rrjedhojë mos mbulimin e nevojave të këtyre fëmijëve duke mos u realizuar qëllimi i implementimit të programeve.

Gjatë intervistave në terren me mësuesit ndihmës, një problematikë dhe shqetësim i evidentuar, ka të bëjë me pajisjen e disa nxënësve me AK me raport mjeko-ligjor, ç' ka sjellë për pasojë dhe pamundësinë nga ana e komisionit për të rekomanduar orë me mësues ndihmës edhe kur kjo nevojë është e dukshme. Gjithashtu edhe në rastet kur Komisionet Multidisiplinare rekomandojnë pajisjen e fëmijës me raport Komisioni Mjeko Ligjor ose KMCAP për të përfituar mësues ndihmës, komisioni shpesh përballlet me refuzim nga prindi. Komisionet Multidisiplinare pas vlerësimit të nevojave është përballur edhe me refuzimin e prindërve për mësuesin ndihmës, sipas tyre orët e rekomanduara janë të pakta dhe nuk plotësojnë nevojat e fëmijës për t'u shoqëruar gjatë gjithë procesit mësimor. Prindi ka refuzuar mësuesin ndihmës duke qëndruar vetë me ta ose duke autorizuar shoqërimin nga persona të tjerë të familjes për të plotësuar nevojat e fëmijës.

- Këto problematika të evidentuara nga grupi i auditimit nuk rezultoi të jenë përcjellë dhe raportuar nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve. Një situatë e tillë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët nuk marrin shërbimin dhe vëmendjen e duhur, por ndikon edhe te nxënësit e tjerë të klasës apo të shkollës të cilët detyrohen të gjenden në situata aspak normale për një zhvillim mësimi cilësorë. Ndryshimet e shpeshta të mësuesve ndihmës të fëmijëve me aftësi të kufizuar kanë ndikim negativ në stabilitetin psiko-emocional për një fëmijë i cili lidhet emocionalisht me mësuesin e tij dhe mësohet të punojë. Komisioni Multidisiplinar i vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar përballlet vazhdimisht me kërkesat e prindërve që fëmijët të mos ndryshojnë mësuesin mbështetës vit pas viti, pasi kjo ndikon negativisht tek ecuria e fëmijëve në mësim dhe stabiliteti i fëmijëve të tyre.

Detyra e Komisionit Multidisiplinar të vlerësimit të nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuar, është që bazuar në vlerësimin që i bëhet fëmijës dhe nevojave që ai ka, të udhëzojë planin edukativ individual të fëmijës me aftësi të kufizuara, që do të zbatohet e ndiqet nga mësuesit ndihmës.

Komisioni Multidisiplinar i vlerësimit ka ushtruar veprimtarinë e tij në mbështetje të nxënësve me aftësi të kufizuar në shkollat publike, por në përbërje të tij në shumicën e rasteve ka munguar mjeku pediatër, i cili edhe kur është përcaktuar nga institucioni përkatës, nuk është paraqitur në procesin e vlerësimit. Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimit Social/ institucionet e saj të varësisë nuk kishin informacion se sa mjek ishin angazhuar në procesin e vlerësimit të Komisioneve Multidisiplinare të ngritur nga Institucionet Arsimore Parauniversitare, fakt i cili tregon mungese serioziteti dhe neglizhencë në kryerjen e një procesi shumë të rëndësishëm siç është vlerësimi e nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuar, për marrjen e masave dhe realizimin e gjithëpërfshirjes.

Mjeku pediatër është shumë i rëndësishëm në Komisionet Multidisiplinare për vlerësimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuar, pasi punonjësit e shërbimit psiko-social dhe mësuesit nuk i njohin diagnozat mjekësore dhe problemet bashkë shoqëruese të tyre. Punonjësit e shërbimit psiko-social dhe mësuesit nuk janë në gjendje të identifikojnë problemet bashkëshoqëruese të zhvillimit të diagnozës të tyre.

Për një numër fëmijësh të cilët paraqiten në Komisionet Multidisiplinare me diagnoza të rënda ose kanë disa diagnoza bashkë shoqëruese, krahas nevojave për mësues ndihmës, nga Institucionet Arsimore Parauniversitare vlerësohen edhe nevoja të tjera përkujdesje (*si, shoqërimi në tualet, higjienizimi, ushqimi gjatë qëndrimit në shkollë, etj.*) por, në detyrat e Komisionit Multidisiplinar nuk parashikohet rekomandimi i personave për përkujdesje, por vetëm i mësuesve për nevoja mësimore dhe/ose sjellore.

Roli i mësuesit ndihmës nuk duhet të dalë nga konteksti dhe nga qëllimi për të cilin ai punësohet.

Komisionet Multidisiplinare kanë për detyrë të rekomandojnë për nxënësit me aftësi të kufizuar edhe shërbime mbështetëse jashtë shkollës (*terapi zhvillimi, terapi sjellje, logopedi, etj.*), por aktualisht numri i institucioneve ku fëmijët mund të marrin këto shërbime janë shumë të pakta.

Numri i vogël i institucioneve me shërbime mbështetëse jashtë shkollës, ul efektin e punës së kryer nga mësuesi ndihmës gjatë procesit të arsimit gjithëpërfshirës.

Nga auditimi në terren rezultoi një ngarkesë pune shtesë në detyrat e anëtarëve të Komisioneve Multidisiplinare, veçanërisht në Zyrën Vendore Arsimore Tiranë, e cila ka edhe numrin më të madh të fëmijëve me AK. Referuar:

- volumit të madh të punës dhe numrit shumë të lartë të vlerësimeve (vetëm për vitin shkollor 2021-2022 janë realizuar rreth 800 vlerësime për nxënës shkollash dhe fëmijë të kopshteve);

- kohës që i duhet komisionit për të vlerësuar një fëmijë,

- vështirësive me të cilat përballet gjatë vlerësimit të fëmijëve me diagnoza të vështira,

- rekomandimet që i jepen gjatë vlerësimit dhe shqyrtimi, si dhe

- organizimi, ruajtja, përgatitja dhe përcjellja e dokumentacionit pranë institucioneve përkatëse; Të cilat deri më sot nuk janë vlerësuar si vështirësi pune dhe anëtarët e Komisioneve Multidisiplinare nuk janë shpërblyer financiarisht për këtë punë voluminoze. Këtë shqetësim e ngritën të gjithë drejtuesit e Njesisë së Shërbimit Psikosocial në DRAP<sup>et</sup> objekt auditimi.

Detyrat e anëtarëve të Komisioneve Multidisiplinare janë detyra të shtuara tej atyre funksionale, për arsye se ky komision nuk funksionon gjatë gjithë vitit shkollor, por është i kushtëzuar prej nevojave të fëmijëve dhe periudhave të vlerësimit.

Veprimtaria dhe volumi i punës i Komisioneve Multidisiplinare, nuk është i njëjtë në të gjitha Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare, për shkak të numrit të ndryshëm të nxënësve me aftësi të kufizuar që vlerësojnë në territorin ku operojnë.

Nuk ka stimulim për realizimin e detyrës së Komisionit Multidisiplinar, sipas volumit të punës.

Jo të gjitha Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar kryejnë monitorime për zbatimin e Planeve Edukative Individuale, në disa Drejtori Rajonale Arsimore Parauniversitare rezulton që nuk korrespondojnë Planet Edukative Individuale të përgatitura me numrin e nxënësve me aftësi të kufizuar. Në të shumtën e rasteve Planet Edukative Individuale nuk kishin një datë të hartimit të tyre, nuk ishin të nënshkruara nga të gjithë anëtarët por, vetëm nga mësuesi ndihmës dhe nuk ishin të shoqëruara me nevojat e mjeteve didaktike që duhen për zhvillimin e tyre sipas specifikave të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Në shumë raste rezultoi se prindërit e firmosnin Planin Edukative Individual por nuk kontribuonin në hartimin e tij, çka tregon se ata nuk kishin pritshmëri të lartë nga shkolla në lidhje me këto programe por më shumë pretendonin që shkolla të shërbente si përkujdesje për disa orë për fëmijët e tyre sesa si institucion mësimor.

Mos përgatitja në nivelin e duhur e mësuesve ndihmës, për hartimin dhe zbatimin Planeve Edukative Individuale për fëmijët me aftësi të kufizuar, si dhe larmi modelesh Planesh Edukative Individuale, lënë hapësira për ngatërresa dhe mos adresim të nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve në mënyrë të përshtatshme.

-Nevojat për mjete didaktike duhet të vlerësohen rast pas rasti nga komisionet e shkollave në përputhje me nevojat dhe mundësitë e fëmijës pasi përgatitja e tyre është pjesë e hartimit të Planeve Edukative Individuale, në mbështetje të edukimit të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuar në sistemin e përgjithshëm.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve është përgjegjëse për monitorimin dhe evidentimin e arritjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Baza e të dhënave, e cila bazohet në të dhëna personale të nxënësve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor

përditësohet çdo vit shkollor. Të dhënat që mblidhen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit janë të detajuara, sipas moshës, gjinisë, klasës, llojit të aftësisë së kufizuar, vendbanimit, por data baza nuk përmban të dhëna mbi llojin e shërbimit të nevojshëm mbështetës që duhet për çdo fëmijë dhe të mjetëve didaktike që mungojnë në rang Zyre Vendore Arsimore. Gjithashtu, nga mbledhja e të dhënave (për vitin 2019-2022) nëpërmjet pyetësorëve të dërguar nga KLSH në DPAD, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore Arsimore u konstatua se ato nuk mbanin një data bazë për fëmijët me aftësi të kufizuara kjo nisur nga fakti se të dhënat e kërkuara nga grupi i auditimit nëpërmjet pyetësorëve të cilat do të duhet të evidentonin punën e kryer nga Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitare dhe Zyrat Vendore Arsimore<sup>35</sup> ndër vite nuk ishin të gatshme por, dhe këto struktura patën vështirësi në grumbullimin e tyre. Gjithashtu në të gjitha rastet nuk rakordojnë të dhënat e referuara nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar ndërmjet atyre të dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Mos pasja e të dhënave të sakta, ndikon në llogaritjen e shpenzimeve ekonomike, pajisjen me stafin e duhur dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme.

### **Nga veprimtaria e KMD**

Nga të dhënat e mbledhura është rritur ndërgjegjësimi i mësuesve dhe prindërve për të vlerësuar nevojat e fëmijëve me AK. Pavarësisht numrit të lartë të fëmijëve me AK të vlerësuar, është arritur të jepet mbështetje me mësues ndihmës pothuajse për të gjithë fëmijët, por numri i mësuesve ndihmës brenda profilit ka qenë i ulët në krahasim me numrin e fëmijëve, pjesa më e madhe e nevojave janë plotësuar nga mësues të profileve të përafërta.

Nxënësit me AK janë ata që kanë nevoja më specifike sesa nxënësit e tjerë në kryerjen e funksioneve të jetës së përditshme dhe në të mësuar, të cilëve u nevojitet mbështetje për t'i kryer sa më mirë ato. Si rregull, të gjithë nxënësit kanë nevoja të ndryshme në të mësuar, në varësi të stileve të të mësuarit dhe të inteligjencës së shumëfishtë, por nxënësit me AK i kanë edhe më të veçanta këto nevoja, sepse përveç stileve të ndryshme të të mësuarit, nevojat e tyre mund ta kenë origjinën edhe në shkaqe që lidhen me dëmtimet fizike dhe njohëse, që ndikojnë në aftësitë në të mësuar.<sup>35</sup>

Nga përgjigjet zyrtare të pyetësorëve të përgatitura nga grupi i auditimit drejtuar subjekteve nën auditim, intervistat në rrethe dhe verifikimi i punës së KMD pasqyrohet se ka patur një ecuri pozitive në procesin e të nxënësve dhe menaxhimit të sjelljeve të nxënësve me AK.

Në përgjigje të pyetësorëve nuk u raportua se sa Plane Edukative Individuale janë hartuar në IA nën juridiksionin e tyre, nuk u raportua për numrin e përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar nga shërbimi kombëtar shtetëror në zonën e tyre

Nuk u raportua për mjetet didaktike të nevojshme (*mjetet ndihmëse që i nevojiten fëmijës për të realizuar procesin mësimor-edukativ*).

Nuk ka monitorim të situatës nga DPAP

Nuk ka një data bazë të FAK në shkolla dhe ecurisë së tyre

Nuk ka një strukturë në DPAP për statistikat pasi kjo është drejtoria që monitoron zbatueshmërinë e implementimit të programeve të MAS.

Nuk ka protokolle të punës për shërbimin psiko-social.

Mësuesit ndihmës ka raste kur janë të pakualifikuar në fushën e pedagogjisë speciale gjë që e vështirëson mbështetjen në cilësinë e duhur të edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të rrjeteve të mësuesve ndihmës bëhet e vështirë në rastet kur këto drejtues ndërrohen/zëvendësohen shpesh dhe investimi i nisur përmes trajnimeve të tyre bëhet i vështirë. Ndjekja e arsimit të zakonshëm me mësues mbështetës për diagnoza të veçanta si, dëmtim të shikimit apo dëgjimit, nuk ka qenë efektive,

---

<sup>35</sup> Udhëzues praktik për hartimin dhe zbatimin e planit edukativ individual (PEI).

pasi mësuesit nuk janë të trajnuar dhe nuk përmbushen nevojat e fëmijës për përdorimin e gjuhës së shenjave apo alfabetit BRAIL.

-Gjithashtu nga intervistat u konstatua se prindërit e fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe shikojnë të cilët ndjekin arsimin special, nuk njohin gjuhën e shenjave apo alfabetin Brail, por kanë përshtatur shenja personale të lindura nga nevoja gjatë viteve.

Mos trajnimi i mësuesve si dhe aftësimi i prindërve sjell që fëmijët të jenë të dyzuar për aftësitë e fituara në shkolla.

#### **Gjetje nga auditimi:**

**14.1-** Në të gjitha Zyrat Vendore Arsimore, *Checklist* e përdorur nga Komisionet Multidisiplinare, me të cilën vlerësohen nevojat arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara, nuk është sipas ICF *Checklist* të miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë por, është shumë e reduktuar, e hartuar nga çdo ZVA dhe e pa miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

- edhe për nxënësit me AK që rivlerësohen periodikisht aplikohet një format rivlerësimi në bazë të arritjeve të pritshme të përcaktuara në Planin Edukativ Individual dhe nevojave që nxënësi mund të shfaq vit pas viti, por edhe kjo e pa unifikuar në nivel kombëtar dhe e pa monitoruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

#### **Konkluzion:**

**14.** *Checklist* e përdorur nga Komisionet Multidisiplinare në të cilën vlerësohen nevojat arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara, riskon evidentimin e saktë e për rrjedhojë mos mbulimin e nevojave të këtyre fëmijëve duke mos u realizuar qëllimi i implementimit të programeve.

#### **Rekomandim:**

**14.1-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve / Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, të marrin masa për unifikimin e ICF *Checklist* për vlerësimin e nevojave arsimore, bazuar në kushtet aktuale për realizimin e tij duke shmangur një proces fiktiv dhe të pa plotë si dhe për monitorimin e procesit të funksionimit të Komisioneve Multidisiplinare për realizimin e gjithëpërfshirjes.

**Menjëherë**

#### **Gjetje nga auditimi:**

#### **15.**

- Gjatë intervistave në terren me mësuesit ndihmës, një problematikë dhe shqetësim i evidentuar, ka të bëjë me pajisjen e disa nxënësve me AK me raport mjeko-ligjor, ç' ka sjellë për pasojë dhe pamundësinë nga ana e komisionit për të rekomanduar orë me mësues ndihmës edhe kur kjo nevojë është e dukshme.

-Një ndër problematikat me shqetësuese të evidentuara gjatë auditimit është se strukturat e Institucioneve Arsimore përballen shpesh me refuzim nga prindi për të vlerësuar nevojat arsimore të fëmijës së tyre nga Komisioni Multidisiplinor.

- Gjithashtu, prindi ka refuzuar mësuesin ndihmës edhe pas vlerësimit të nevojave nga KMD, pasi sipas tyre, orët e rekomanduara janë të pakta dhe nuk plotësojnë nevojat e fëmijës për t'u shoqëruar gjatë gjithë procesit mësimor. Në këto raste prindi ka qëndruar vetë në klasë me fëmijën ose ka autorizuar shoqërimin nga persona të tjerë të familjes për të plotësuar nevojat e fëmijës.

- Këto problematika të evidentuara nga grupi i auditimit nuk rezultoi të janë përcjellë dhe raportuar nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.

#### **Konkluzioni:**

**15.** Një situatë e tillë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët nuk marrin shërbimin dhe vëmendjen e duhur, por ndikon edhe te nxënësit e tjerë të

klasës apo të shkollës të cilët detyrohen të gjenden në situata aspak normale për një zhvillim mësimi cilësorë.

**Rekomandim:**

**15.1-**Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar të marrin masa për të identifikuar dhe raportuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar të gjitha rastet e fëmijëve, prindërit e të cilëve kanë refuzuar të vlerësojnë fëmijët nga strukturat e Institucioneve Shëndetësore apo Arsimore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**15.2-**Shërbimi psiko-social i shkollës të marrë masa për të organizuar takime për punë bindëse me këta prindër dhe të informojë Zyrën Vendore Arsimore, e më tej, mbi ecurinë e problematikës me ta.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**15.3-** Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar të evidentojnë të gjitha rastet ku IA identifikojnë fëmijë të cilët duhet të kenë mbështetje për t'i siguruar akses në të gjitha shërbimet nga të cilat përfiton sipas legjislacionit në fuqi dhe t'i referojnë rastet në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për neglizhencë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Gjetje nga auditimi:**

**16.** Për një numër fëmijësh të cilët paraqiten në Komisionet Multidisiplinare me diagnoza të rënda ose kanë disa diagnoza bashkë shoqëruese, krahas nevojave për mësues ndihmës, nga Institucionet Arsimore Parauniversitare vlerësohen edhe nevoja të tjera përkujdesje (*si, shoqërimi në tualet, higjienizimi, ushqimi gjatë qëndrimit në shkollë, etj.*) por, në detyrat e Komisionit Multidisiplinare nuk parashikohet rekomandimi i personave për përkujdesje, por vetëm i mësuesve për nevoja mësimore dhe/ose sjellore.

**Konkluzion:**

**16.** Roli i mësuesit ndihmës nuk duhet të dalë nga konteksti dhe nga qëllimi për të cilin ai punësohet.

**Rekomandim:**

**16.1-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nisur nga praktikat më të mira të rajonit, të marrin masa jo vetëm për plotësimin me mësues ndihmës, por edhe për krijimin e strukturave ndihmëse për asistencë në ambientet e Institucioneve Arsimore, në bazë të fëmijëve me aftësi të kufizuar me diagnoza të rënda.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Gjetje nga auditimi:**

**17.** Komisioni Multidisiplinar i vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar përballet vazhdimisht me kërkesat e prindërve që fëmijët të mos ndryshojnë mësuesin mbështetës vit pas viti, pasi kjo ndikon negativisht tek ecuria e fëmijëve në mësim dhe stabiliteti i fëmijëve të tyre.

**Konkluzioni:**

**17.** Ndryshimet e shpeshta të mësuesve ndihmës të fëmijëve me aftësi të kufizuar kanë ndikim negativ në stabilitetin psiko-emocional për një fëmijë i cili lidhet emocionalisht me mësuesin e tij dhe mësohet të punojë.

**Rekomandim:**

**17.1-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve / Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, të marrin masa alternative për mos ndryshimin e mësuesve ndihmës, pa arsye objektive, me përjashtim të rasteve kur do të zëvendësohen me mësues të arsimit special.

## Menjëherë dhe në vijimësi

### Gjetje nga auditimi:

**18.-** Komisioni Multidisiplinar i vlerësimit ka ushtruar veprimtarinë e tij në mbështetje të nxënësve më aftësi të kufizuar në shkollat publike, por në përbërje të tij në shumicën e rasteve ka munguar mjeku peditër, i cili edhe kur është përcaktuar nga institucioni përkatës, nuk është paraqitur në procesin e vlerësimit.

-Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimit Social/ institucionet e saj të varësisë nuk kishin informacion se sa mjek ishin angazhuar në procesin e vlerësimit të Komisioneve Multidisiplinare të ngritur nga Institucionet Arsimore Parauniversitare, fakt i cili tregon mungese serioziteti dhe neglizhencë në kryerjen e një procesi shumë të rëndësishëm siç është vlerësimi e nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuar, për marrjen e masave dhe realizimin e gjithëpërfshirjes.

- Komisionet Multidisiplinare kanë për detyrë të rekomandojnë për nxënësit me aftësi të kufizuar edhe shërbime mbështetëse jashtë shkollës (*terapi zhvillimi, terapi sjellje, logopedi, etj.*), por aktualisht numri i institucioneve ku fëmijët mund të marrin këto shërbime janë shumë të pakta.

### Konkluzion

**18.-** Mjeku peditër është shumë i rëndësishëm në Komisionet Multidisiplinare për vlerësimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuar, pasi punonjësit e shërbimit psiko-social dhe mësuesit nuk i njohin diagnozat mjekësore dhe problemet bashkë shoqëruese të tyre. Punonjësit e shërbimit psiko-social dhe mësuesit nuk janë në gjendje të identifikojnë problemet bashkëshoqëruese të zhvillimit të diagnozës të tyre.

- Numri i vogël i institucioneve me shërbime mbështetëse jashtë shkollës, ul efektin e punës së kryer nga mësuesi ndihmës gjatë procesit të arsimit gjithëpërfshirës.

### Rekomandim:

**18.1-** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve të marrin masa për lidhjen e një marrëveshjeje për të bërë detyruese prezencën e mjekëve në procesin e vlerësimit të Komisioneve Multidisiplinare në arsim, duke parë si mundësi që kur nuk është i mundur mjeku i qendrës shëndetësore, të paktën të jenë pjesëmarrës mjekët e shkollave gjatë këtij procesi.

## Menjëherë dhe në vijimësi

### Rekomandim:

**18.2-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve të bashkëpunojë me njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim që njësia psiko-sociale të bëjë bashkërendimin e terapisë së shkollës me terapinë e cila merret në qendrat sociale në rang ZVA.

## Menjëherë dhe në vijimësi

### Gjetje nga auditimi:

**19.** Veprimtaria dhe volumi i punës i Komisioneve Multidisiplinare, të cilën vlerësojnë nevojat arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuar, nuk është i njëjtë në të gjitha Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare, për shkak të numrit të ndryshëm të nxënësve me aftësi të kufizuar që vlerësojnë në territorin ku operojnë. Detyrat e anëtarëve të Komisioneve Multidisiplinare janë detyra të shtuara tej atyre funksionale, por nuk ka stimulim për realizimin e detyrës, sipas volumit të punës që kryejnë. Për arsye se ky komision nuk funksionon gjatë gjithë vitit shkollor, por është i kushtëzuar prej nevojave të fëmijëve dhe periudhave të vlerësimit

### Rekomandim:

**19.1** -Nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, të merren masa për të evidentuar volumin e punës së Komisioneve Multidisiplinare, numrin e rekomandimeve që ato japin gjatë vlerësimit, shqyrtimit, organizimit, ruajtjes, përgatitjes dhe përcjelljes së dokumentacionit

pranë institucioneve përkatëse, duke vlerësuar ngarkesën e tyre si dhe duke e konsideruar si vështirësi pune.

#### **Në vijimësi**

**19.2-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve me qëllim kryerjen sa më me efektivitet të detyrave të konsiderojë dhënien e një incentive ekonomike, ndaj anëtarëve të Komisioneve Multidisiplinare, në formë honorari ose shpërblimi në varësi të volumit të vlerësimeve që trajtohen përgjatë një viti, për ti dhënë seriozitetin e duhur procesit.

#### **Brenda vitit 2023**

#### **Gjetje nga auditimi:**

**20.1-** Jo të gjitha Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar kryejnë monitorime për zbatimin e Planeve Edukative Individuale, në disa Drejtori Rajonale Arsimore Parauniversitare rezulton që nuk korrespondojnë Planet Edukative Individuale të përgatitura me numrin e nxënësve me aftësi të kufizuar.

**20.2** -Në të shumtën e rasteve Planet Edukative Individuale nuk kishin një datë të hartimit të tyre, nuk ishin të nënshkruara nga të gjithë anëtarët por, vetëm nga mësuesi ndihmës dhe nuk ishin të shoqëruara me nevojat e mjeteve didaktike që duhen për zhvillimin e tyre sipas specifikave të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Në shumë raste rezultoi se prindërit e firmosnin Planin Edukative Individual por, nuk kontribuonin në hartimin e tij duke mos patur pritshmëri të lartë nga shkolla në lidhje me këto programe.

#### **Konkluzion:**

**20.** Mos përgatitja në nivelin e duhur e mësuesve ndihmës, për hartimin dhe zbatimin Planeve Edukative Individuale për fëmijët me aftësi të kufizuar, si dhe larmi modelesh Planesh Edukative Individuale, lënë hapësira për ngatërresa dhe mos adresim të nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve në mënyrë të përshtatshme.

-Nevojat për mjete didaktike duhet të vlerësohen rast pas rasti nga komisionet e shkollave në përputhje me nevojat dhe mundësitë e fëmijës pasi përgatitja e tyre është pjesë e hartimit të Planeve Edukative Individuale, në mbështetje të edukimit të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuar në sistemin e përgjithshëm.

#### **Rekomandime:**

**20.1-** Institucionet Arsimore Parauniversitare duhet ti kushtojnë rëndësi hartimit dhe monitorimit të zbatimit të Planeve Edukative Individuale duke i shoqëruar me nevojat specifike të mjeteve didaktike për zbatimin e tyre. Këto programe duhet të hartohen në bashkëpunim me prindërit/kujdestarët ligjorë të fëmijëve me aftësi të kufizuar por, edhe në rastet kur prindi nuk ka kapacitetin e duhur, për të kontribuar në hartimin e tyre, ata detyrimisht duhet të njihen me këto programe, në mënyrë që veprimtaritë që zhvillohen në shkollë të zhvillohen edhe në shtëpi, të plotësojnë dhe përforcojnë njëra tjetrën.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**20.2-** Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar të marrin masa për monitorimin e zbatimit të Planeve Edukative Individuale nga Institucionet Arsimore Parauniversitare dhe mësuesit ndihmës si dhe të identifikojnë dhe mbledhin informacione mbi nevojat specifike të mjeteve didaktike që nevojiten rast pas rasti për zbatimin e tyre në rang Zyre Vendore Arsimore në mbështetje të edukimit të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuar.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**20.3-** Zyrat Vendore Arsimore, njësitë e shërbimit psikosocial në Institucionet Arsimore Parauniversitare, të hartojnë programe sensibilizimi me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar në lidhje me rëndësinë që kanë Planet Edukative Individuale në mbështetje të edukimit dhe socializmit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në arsimin gjithëpërfshirës.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **Gjetje nga auditimi:**

**21.** Ministria e Arsimit dhe Sporteve është përgjegjëse për monitorimin dhe evidentimin e arritjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Baza e të dhënave, e cila bazohet në të dhëna personale të nxënësve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor përditësohet çdo vit shkollor. Të dhënat që mblidhen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit janë të detajuara, sipas moshës, gjinisë, klasës, llojit të aftësisë së kufizuar, vendbanimit, por data baza nuk përmban të dhëna mbi llojin e shërbimit të nevojshëm mbështetës që duhet për çdo fëmijë dhe të mjeteve didaktike që mungojnë në rang Zyre Vendore Arsimore. Gjithashtu, nga mbledhja e të dhënave (për vitin 2019-2022) nëpërmjet pyetësorëve të dërguar nga KLSH në DPAD, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore Arsimore u konstatua se ato nuk mbanin një data bazë për fëmijët me atësi të kufizuara kjo nisur nga fakti se të dhënat e kërkuara nga grupi i auditimit nëpërmjet pyetësorëve të cilat do të duhet të evidentonin punën e kryer nga Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitare dhe Zyrat Vendore Arsimore<sup>-të</sup> ndër vite nuk ishin të gatshme por, dhe këto struktura patën vështirësi në grumbullimin e tyre. Gjithashtu në të gjitha rastet nuk rakordojnë të dhënat e referuara nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar ndërmjet atyre të dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

**Konkluzion:**

**21.** Mos pasja e të dhënave të sakta, ndikon në llogaritjen e shpenzimeve ekonomike, pajisjen me stafin e duhur dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme.

**Rekomandim:**

**21.1-** Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, të rakordojnë dhe të përmirësojnë mbledhjen e të dhënave për zbatimin e ligjeve dhe politikave për arsimin gjithëpërfshirës dhe aksesueshmërinë e infrastrukturës shkollore, përfshirë llojin e shërbimit të nevojshëm mbështetës që duhet për çdo fëmijë dhe të mjeteve didaktike që mungojnë në rang Zyre Vendore Arsimore.

**Menjëherë dhe vazhdimësi**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.4049/5, datë 20.12.2022 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z. E. T., Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Observacioni i paraqitur nga subjekti është protokolluar në KLSH me nr. 589/6 datë 21.20.2022, u shqyrtua me kujdes dhe u konkludua:

**Pretendimi i subjektit:**

Pikërisht nga ana e MAS dhe ASCAP sqarohet se nga ana e ascap është bërë monitorimi i punës së rrjeteve profesionale dhe ka dëshmi të raporteve të takimeve të pothuajse të gjithë rrjeteve të mësuesve ndihmës. Gjithashtu bëhet i ditur se MAS ka hartuar urdhërin nr. 427 datë 02.11.2021 për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e modelit të qendrave burimore për nxënësit me AK.

**Oëndrimi i institucionit: Oëndrimi i Grupit të auditimit:**

Arsyetimi i cituar nga ana e MAS pranohet pjesërisht, pasi nuk është paraqitur ndonjë dokument justifikues mbi punën e grupit të ngritur për përcaktimin e qendrave burimore për nxënësit me aftësi të kufizuara. Ndërsa për sa i përket monitorimit të rrjeteve profesionale nga ASCAP merret në konsideratë shpjegimi i dhënë.

**5. PËRMBLEDHJE**

Ky auditim, është konceptuar të vlerësojë efektivitetin e veprimtarisë së sistemin arsimorë parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Për sa më sipër referuar edhe

konceptimit të piramidës së pyetjeve, në mënyrë të përmbledhur për periudhën objekt auditimi rezultoi se:

Sistemi arsimor parauniversitar vitet e fundit ka pësuar zhvillim pozitiv për avancimin e gjithëpërfshirjes në arsim, por ka ende nevojë për punë më të mirë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe institucioneve në varësi, sidomos për fuqizimin e sistemit të gjithëpërfshirjes dhe monitorimin e tij. Kapacitetet aktuale të shkollave dhe infrastruktura nuk lejojnë zhvillimin e plotë të konceptit të gjithëpërfshirjes. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në moshë shkollare të regjistruar në arsimin parauniversitar, është shtuar nga viti në vit, por mbetet ndjeshëm i ulët në krahasim me numrin e tyre në total në rang Republike. Me gjithë rritjen e ndjeshme të numrit të mësuesve ndihmës në shkollat e zakonshme dhe trajnimet e zhvilluara, kapacitetet e tyre profesionale nuk janë ende në nivelin e kërkuar në raport me rolin që kanë. Ndryshimi çdo vit i mësuesve ndihmës bën të mundur humbjen e eksperiencave të mësuar gjatë vitit mësimor nga fëmijët si dhe ngurrimin për të investuar në këtë fushë nga vetë ata, kur nuk kanë sigurinë e vazhdimësisë.

Nivelet e pakënaqshme të financimit nga buxheti i shtetit për të gjithë arsimin parauniversitar në përgjithësi, ndikon direkt edhe për integrimin e kësaj shtresë vulnerabil të shoqërisë në arsimin gjithëpërfshirës dhe për pasojë krijon jo pak problematika lidhur me nivelet e aksesit, gjithëpërfshirjes në mësim, nxënien dhe efikasitetin e tyre në arsim.

Ministria e Arsimit dhe e Sportit si dhe institucionet vendore të arsimit parauniversitar përgjegjës për integrimin në arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara, nuk kanë planifikuar buxhet specifik të veçantë mbështetur në numrin faktik të fëmijëve me aftësi të kufizuara që janë duke frekuentuar arsimin gjithëpërfshirës apo që pritet të frekuentojnë këtë arsim në vitet në vazhdim. Buxhetet për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara si në nivel qendror dhe vendor nuk janë programuar, planifikuar dhe dedikuara si shpenzime specifike të veçanta buxhetore, por janë përfshirë së bashku me zërat e tjerë të shpenzimeve të përgjithshme të arsimit parauniversitar. Përmendim shpenzimet për: pagat e mësuesve ndihmës apo asistentëve; kualifikimi dhe trajnimin e mësuesve ndihmës apo asistentëve, për tekstet shkollare dhe mjetet didaktike speciale, transportin e nxënësve, investimet për aksesueshmërinë dhe përshtatshmërinë në shkolla, apo edhe ndonjë zë shpenzimi specifik të diktuar sipas rastit të veçantë të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Niveli i ulët i financimit nga buxheti i shtetit për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin gjithëpërfshirës, mos programimi dhe mos parashikimi i buxheteve të veçanta enkas për këtë shtresë vulnerabil të shoqërisë, krijon problematika në integrimin e tyre në arsimin gjithëpërfshirës, pa diskriminim dhe të barabartë.

Roli i mësuesit ndihmës është kryesor në përfshirjen sociale, promovimin dhe të të mësuarit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mësuesi ndihmës është një urë lidhëse midis prindërve dhe aktorëve të tjerë në shkollë, drejtorisë së shkollës, mësuesve, nxënësve, strukturave të shkollës etj. Nga profesionalizmi, aftësia dhe zhvillimi profesional i mësuesve ndihmës varen edhe përmirësimi e progresi i çdo fëmije sado me vështirësi të konsiderueshme qofshin ata. Mësuesit ndihmës ofrojnë këshilla dhe burimet për mësuesin e klasës të cilat do ta ndihmojnë atë në procesin e vlerësimit dhe në zhvillimin e klasës. Qëllimi kryesor i një mësuesi ndihmës është të vëzhgojë me kujdes kapacitetet dhe potencialin e fëmijëve për të gjetur hapësira të cilat do mundësojnë përfshirjen e fëmijës në lëndë të caktuara me programin e klasës që fëmija frekuenton, duke shmangur kështu të gjithë faktorët objektiv apo subjektiv të cilët mund të çojnë në mosarritjen e objektivave dhe në realizimin e detyrave të tyre të përcaktuara në Udhëzimin Nr.26, datë 25.11.2019 për “Mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të Arsimit Parauniversitar”.

Mësuesit ndihmës janë të pranishëm në institucionet e arsimit parauniversitar si në zona urbane ashtu edhe në zonat rurale.

- Pjesa më e madhe e mësuesve ndihmës (rreth 60% e tyre) punojnë dhe mbështesin 1-2 fëmijë me aftësi të kufizuara; Rreth 25% e mësuesve ndihmës mbështesin dhe punojnë me më shumë se tre fëmijë me aftësi të kufizuara;

Gati 50% e mësuesve ndihmës janë të rinj në këtë pozicion, me një eksperiencë deri në 3 vite si mësues ndihmës;

Pothuajse të gjithë mësuesit ndihmës punojnë në arsimin e detyruar. Pothuajse të gjithë mësuesit ndihmës janë femra.

Mësuesit ndihmës të angazhuar në sistemin arsimor parauniversitar janë përpjekur të ndjekin trajnime për zhvillimin profesional të tyre. Format më të frekuentuara të trajnimit janë takimet e rrjeteve profesionale dhe takimet e shkëmbimet më mësues të tjerë të së njëjtës shkollë. Gjithashtu ato kanë interes dhe janë përpjekur të ndjekin trajnime të akredituara të ofruara nga agjenci që janë akredituara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Mësuesit ndihmës vlerësojnë si një institucion të rëndësishëm Komisionin e shkollës për fëmijët me aftësi të kufizuara i cili mundëson orët e nevojshme për të mbështetur fëmijën në nevojë dhe planifikimin e veprimtarive edukative për të.

Mësuesit ndihmës e shohin bashkëpunimin me mësuesin e klasës me një rëndësi të veçantë në hartimin e planeve individuale dhe vlerësimin e nxënësit me aftësi të kufizuar sipas nivelit të arritjeve të fushave të zhvillimit. Gjithashtu, Bashkëpunimi me prindërit e fëmijës me aftësi të kufizuar, konsiderohet nga mësuesit ndihmës si faktor i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit dhe progresit të fëmijës.

Një problem madhor për mësuesit janë fëmijët që nuk janë diagnostikuar dhe që prindërit e tyre e mohojnë aftësinë e kufizuar të fëmijëve të tyre, prandaj mësuesve nuk u është dhënë e drejta të kenë një klasë me një numër të vogël fëmijësh ose të kërkojnë një mësues ndihmës apo të punojnë me programe PEI me këta fëmijë. Roli i prindërve është i domosdoshëm për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës të të nxënës, bashkëpunimi ndërmjet të gjitha lidhjeve përkatëse, çon në progresin e fëmijës dhe në ndryshimin e kulturës së fëmijëve të tjerë, prindërve dhe kulturës së shkollës në përgjithësi. Në praktikë, kjo është një nga sfidat kryesore për mësuesit.

Mësuesit ndihmës nuk kanë pasur mundësi mjaftueshëm dhe nuk kanë shfrytëzuar sa duhet bashkëpunimin me partnerë të tjerë të specializuar për punën me fëmijët me aftësi të kufizuar në komunitetin e tyre, duke përfshirë këtu edhe qendrat e shërbimit social për të përfutur profesionalisht nga specialistët që punojnë aty. Nevoja për trajnim dhe aftësim profesional e mësuesve ndihmës duket të jetë shumë e madhe. Ata pohojnë dhe vlerësojnë të nevojshme në nivel të lartë një sërë tematikash si: Metoda dhe strategji të mbështetjes në klasë të fëmijëve me aftësi të kufizuar; Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë për të mbështetur fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta; Dokumentacioni i nevojshëm që mban mësuesi ndihmës; Hartimi i programeve edukative individuale efektiv; Karakteristikat kryesore (format e manifestimit) të llojeve të ndryshme të pa(aftësive); e të tjera që janë cilësuar më sipër në raport.

Nga takimet dhe intervistat dhe verifikimet në terren konstatohet se në Shqipëri, sistemi arsimorë parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara;

- ka mungesa të shumta të bazës materiale didaktike

- nuk mbulohet me mësues ndihmës secili fëmijë me aftësi të kufizuar

- në shkolla mungojnë ambientet për klasa zhvillimore

- në Zyrën Vendore Arsimore Korçë në asnjë rast nuk ka marr pjesë doktori në komisionet Multidisiplinare, po ashtu edhe në Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës e Zyrën Vendore Arsimore Tiranë doktori nuk ka qenë i rregullt në ndjekjen e komisioneve Multidisiplinare, mungesa e të cilit shpesh është bërë shkak për vonesa të vlerësimit të fëmijëve dhe pasojat që kjo pas sjell.

- detyrat e anëtarëve të Komisionit Multidisiplinar janë detyra të shtuara, për arsye se ky komision nuk mund të funksionojë gjatë gjithë vitit shkollor, po është i kushtëzuar prej nevojave të fëmijëve dhe periudhave të vlerësimit, etj.
- komisionet Multidisiplinare nuk janë të trajnuara për hartimin e dokumentacionit, për këtë arsye dosjet e fëmijëve kishin mangësi
- programet PEI shpesh hartoheshin në mënyrë formale
- në çdo rast në të gjitha Zyrat Vendore Arsimore dhe Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitare nuk është arritur të bëhet vlerësimi i fëmijëve në bazë të **ICF Checklist** të miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë por, secila Zyrë Vendore Arsimore ka përdorur metodika të hartuara nga kryetarët e komisionit të Multidisiplinare por, edhe këto të pa miratuara.
- dokumentacioni i plotësuar nga komisionet Multidisiplinare në disa raste rezulton i plotësuar formalisht
- nga auditimi u konstatua se nuk ka buxhet të dedikuar për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, pasi në veçanti financimi me burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës, është detyrim i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe njësisë arsimore vendore për të planifikuar aktivitetet e parashikuara sipas qëllimeve politike në zbatim të Planit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.
- në shumë raste prindërit nuk e pranojnë rekomandimin e shkollës që fëmija i tyre ka nevojë për ndihmë më të specializuar në lidhje me arsimimin
- nuk ka patur bashkëpunim ndërmjet institucioneve përgjegjëse për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- strukturat dhe buxheti i Drejtorive Rajonale Arsimore Parauniversitare, është i pamjaftueshëm për të mbuluar monitorimin e të gjithë zonës që kanë nën administrim, po ashtu e njëjta situatë është edhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.
- pjesa më e madhe e mësuesve ndihmës nuk janë të profilit “Arsim special”, por vijnë nga profile të ndryshme nga portali “Mësues për Shqipërinë”, pasi numri i mësuesve me profilin “Arsim special” aplikantë në portal ka qenë shumë i ulët në raport me nevojat.

## **6. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE**

A. B. – *Përgjegjëse e grupit të auditimit;*

L. B. – *Anëtare e grupit të auditimit;*

B. A. – *Anëtar i grupit të auditimit;*

A. T. - *Anëtare e grupit të auditimit.*



A. Z.


**DREJTOR I DEPARTAMENTIT**

## 7. SHTOJCAT

Foto nga vizitat në terren në shkolla të ndryshme në ZVA Tiranë, Korçë, Fier dhe Lezhë.











Aneks nr. 4.1.1

**Aneksi nr.4.1 Të dhëna nga pyetësi i plotësuar nga DRAP-et**

Vitet	1/1 Fëmijë të evidentuar 6-19 vjeç		1/2 Fëmijë me AK që kanë ndjekur nivele të ndryshme të arsimit PU		1/2 FAK që asistohen në ambientet e shtëpive të tyre nga mësuesit mbështetës	1/2 FAK në moshë për ndjekjen e arsimit parauniversitar, por nuk janë të përfshirë në arsim		1/4 Braktisje të vitit ushtrimor	1/5 Vlerësimi i progresit të secilit prej nxënësve me AK në raporte		1/6 FAK të vlerësuar nga Komisionet Multidisiplinare		1/7 FAK që kanë kaluar nga arsimi publik në arsimin privat	1/8 Rolin e mësuesit ndihmës e luan prindë	1/9 FAK në shkolla me klasa kolektive	1/10 Shkolla në juridiksionin		1/13 Prindër të FAK që janë të angazhuar në këshillat e prindërve	Nr. Nxënës AK që nuk vijojnë arsimin	FAK kanë kaluar nga frekuentimi i arsimit të zakonshëm në arsim special	1/11 nuk është pranuar nga prindi apo kujdestari përgjegjës rekomandimi i komisionit Multidisiplinar për trajtim të fëmijës me program të veçantë individual apo për trajtimin në shkolla speciale?
	Arsimi bazë	Arsimi mesëm	Total	Femra		Raporte	arsimin special		arsimin e zakonshëm	Total	Të aksesueshme	Total				Të aksesueshme					
2019-20	1186	1080	106	30	8	1	0	1,039	78	1,016	3	73	35	469	194	89	8	3	75		

	2020-21	1399	1274	125	4	3	2	0	1,148	12	1,233	5	65	43	498	190	54	3	5	44
	2021-22	1419	1279	140	6	4	3	0	1,186	61	1,253	15	69	53	503	228	84	4	15	30
FIER	2019-20	672	0	0	0	0	0	0	672	0	672	0	1	8	55	49	34	0	0	18
	2020-21	668	0	0	0	0	0	0	668	0	668	1	1	10	56	50	34	0	0	8
	2021-22	759	0	0	0	0	0	0	759	0	759	0		9	55	50	47	0	0	8
LEZHË	2019-20	0	57	2	0	0	0	0	59	0	59	0	0	3	0	2	0	0	0	0
	2020-21	0	59	1	0	0	0	0	60	0	60	0	0	3	0	2	0	0	0	0
	2021-22	0	64	3	0	0	0	0	64	0	64	0	0	3	0	2	0	0	0	0
KORÇË	2019-20	809	803	0	4	0	0		433		803	803	0		100	280	37	0	6	15
	2020-21	821	818	0	10	2	1		421		818	818	0		102	246	47	2	6	25
	2021-22	842	839	0	12	3	2	2	488	1	838	838	0		104	249	51	3	7	25

Burimi i informacionit: Plotësimi i pyetësorit DRAP –Durrës, Fier, Lezhë dhe Korçë.

### Aneksi nr.4.1 Përgjigje të pyetësorëve nga DRAP Fier, Durrës, Lezhe dhe Korçë.

NR.	NË LIDHJE ME PYETJET E PYETËSORIT:	PËRGJIGJET E PYETËSORIT SIPAS DRAP <sup>EVE</sup>										
		DRAP Fier	DRAP Durrës	DRAP Lezhë	DRAP Korçë							
	<b>Legjenda</b>											
3	Sa është numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në nivele të ndryshme të arsimit, në juridiksionin tuaj për vitet arsimore 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, të cilët janë në moshë për ndjekjen e arsimit parauniversitar, por nuk janë të përfshirë në arsim, të ndarë sipas llojit të AK dhe gjinisë?	<b>DRAP Fier</b> dhe ZVAP-et e varësisë nuk diponojnë të dhëna në lidhje me nxënësit të cilët janë në moshë për ndjekjen e arsimit parauniversitar, por nuk janë të përfshirë në arsim, të ndarë sipas llojit të AK dhe gjinisë. <b>DRAP Durrës</b> Gjatë vitit 2019-2020 janë evidentuar 8 fëmijë nga të cilët 1 është femra. Gjatë vitit 2020-2021 janë evidentuar 3 fëmijë nga të cilët 2 janë femra. Gjatë viti 2021-2022 janë evidentuar 4 fëmijë nga të cilët 3 janë femra.	<b>DRAP Lezhë</b> - Nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuara që nuk janë të përfshirë në arsim.	<b>DRAP Korçë</b> <table border="1"> <tr> <th>2019</th> <th>2020</th> <th>2021</th> <th>2022</th> </tr> <tr> <td>809</td> <td>821</td> <td>842</td> <td>806</td> </tr> </table>	2019	2020	2021	2022	809	821	842	806
2019	2020	2021	2022									
809	821	842	806									
4	A keni raste të braktisjes së vitit arsimor nga fëmijët me AK? Nëse po, vini në dispozicion arsyet e braktisjes dhe evidencën, për vitet arsimore 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.	<b>DRAP Fier</b> dhe ZVAP-et e varësisë raportojnë se nuk kanë raste të braktisjes së shkollës nga nxënës me AK. <b>DRAP Durrës</b> - Përgjigja lidhet me pyetjen e mësipërme. Statistika bashkëlidhur <b>DRAP Lezhë</b> : Nuk kemi raste të braktisjes së nxënësve me AK, në arsim në periudhat e mësipërme. <b>DRAP Korçë</b> <table border="1"> <tr> <th>2019</th> <th>2020</th> <th>2021</th> <th>2022</th> </tr> <tr> <td>0</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> </table> Arsyeja e braktisjes së shkollës për këta nxënës ka qenë fakti i neglizhencës nga ana e prindërve. Rastet ndiqen nga njësia e mbrojtjes së fëmijëve pranë	2019	2020	2021	2022	0	0	2	0		
2019	2020	2021	2022									
0	0	2	0									
12	Sa u janë siguruar tekste për mësimin e gjuhës së folur, materiale mësimore ndihmëse në formatin e përshtatshëm (Brail/ shkronja), fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë? Vini në dispozicion dokumentet përkatëse.	<b>DRAP Fier</b> - Bazuar në raportimet e ZVAP-eve të varësisë nuk deklarohen fëmijë që kanë nevojë për materiale mësimore ndihmëse në formatin e përshtatshëm (Brail)	<b>DRAP Durrës</b> - Informacion që e disponon ZVAP Tiranë.	<b>DRAP Lezhë</b> - Nuk kemi nxënës të cilët paraqesin nevojën për tekste për mësimin e gjuhës së folur etj.	<b>DRAP Korçë</b> –s' ka të dhëna							
14	Si janë të shpërndarë në klasa fëmijët me AK, në ato shkolla (jo speciale) që frekuentohen prej tyre? Prej sa vitesh frekuentojnë ata institucionin arsimor? Sa janë të regjistruar rishtazi dhe sa janë të transferuar?	<b>DRAP Fier</b> - Numri më i lartë i nxënësve me AK në një klasë është 2, por gjithmonë është synuar që të jetë 1. Frekuentimi i shkollës ka nisur që në klasë të I (parë) dhe ka vazhdimësi sipas grup moshave. 2019-2020 1 fëmijë i regjistruar rishtazi 2020-2021 4 fëmijë te regjistruar rishtazi										

NR.	NË LIDHJE ME PYETJET E PYETËSORIT:	PËRGJIGJET E PYETËSORIT SIPAS DRAP <sup>P-EVE</sup>																			
		DRAP Fier	DRAP Durrës	DRAP Lezhë	DRAP Korçë																
	<b>Legjenda</b>																				
	A ka fëmijë që t ju jetë ndërprerë asistencë me mësues ndihmës? Cila ka qenë arsyeja e ndërprerjes së asistencës?	<p>2021-2022 0 fëmijë të regjistruar rishtazi</p> <p>-Rastet e ndërprerjes së asistencës me mësues ndihmës kanë ndodhur vetëm për shkaqe ligjore (kur mungonte KML ose KMCAP, rrjedhimisht nxënësi nuk mund të quhet nxënës me AK dhe nuk asistohet me mësues ndihmës).</p> <p><b>DRAP Durrës</b> - Këta fëmijë ndjekin në vazhdimësi arsimimin e tyre. Nga informacioni i zyrate nuk ka raste të tilla.</p> <p><b>DRAP Lezhë</b></p> <p><b>DRAP Korçë</b> Që prej regjistrimit në klasë parë</p> <p>Sa janë të regjistruar rishtazi dhe sa janë të transferuar?</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>2019</th> <th>2020</th> <th>2021</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Sa nxënës me AK janë transferuar</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> <p>Transferimi i nxënësve me AK bëhet për shkaqe si transferimi i prindërve në qytet tjetër ose nga zona rurale në zonë urbane me të njëjtat procedura si nxënësi e tjerë.</p> <p>A ka fëmijë që t ju jetë ndërprerë asistencë me mësues ndihmës?</p> <p>Cila ka qenë arsyeja e ndërprerjes së asistencës?</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>2019</th> <th>2020</th> <th>2021</th> <th>2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>					2019	2020	2021	Sa nxënës me AK janë transferuar	2	3	2	2019	2020	2021	2022	0	0	1	3
	2019	2020	2021																		
Sa nxënës me AK janë transferuar	2	3	2																		
2019	2020	2021	2022																		
0	0	1	3																		
14	Gjatë periudhës së mbylljes së institucioneve arsimore për shkAK të situatës së COVID 19 dhe zhvillimit të mësimin në kushte shtëpie: A kanë raportuar mësuesit ndihmës të shkollave publike çdo javë për punën e bërë me fëmijët me aftësi të kufizuara? A keni evidencë të ndjekjes së shkollës on-line të fëmijëve me AK? -A janë monitoruar dhe a ka raporte monitorimi për punën e bërë me këta fëmijë? Vini në dispozicion një data bazë mbi prezencën e tyre në mësimin on-line për vitet arsimore 2019-2020, 2020-2021.	<p><b>DRAP Fier</b> - Në nivel DRAP-i mësuesit kanë raportuar për punën e realizuar online dhe për ecurinë e fëmijëve me AK, paralelisht kanë raportuar në nivel shkolle e ZVAP. Raportet kanë qenë sipas periudhave e bazuar në PEI.</p> <p><b>DRAP Durrës</b> - Nga informacionet e marra gjatë periudhës së pandemisë rezultoi se 709 fëmijë autik ka gjithsej në institucione.</p> <p>Nga këta fëmijë, 629 prej tyre kanë ndjekur mësimin on-line.</p> <p><b>DRAP Lezhë</b> Në klasat që frekuentohen nga fëmijët me AK, maksimumi ka 2 nxënës me AK në të njëjtën klasë. Rastet janë të rralla.</p> <p><b>DRAP Korçë</b> - Mësuesit ndihmës raportojnë tek drejtori i shkollës përkatëse për punën e kryer gjatë zhvillimit on-line të mësimin</p>																			
<b>III</b>	<b>PËR MONITORIMIN:</b>																				
1.	A janë ngritur në DPAP dhe DRAP (Fier, Durrës, Lezhë, Korçë) strukturat dhe kushtet e përshtatshme për monitorimin dhe inspektimin e ZVA-ve dhe IA publike në juridiksionin e tyre? -A janë të mjaftueshme këto struktura? Nëse jo, komentoni problematikat që hasen.	<p><b>DRAP Fier</b> - DRAP Fier ka realizuar sipas grafikut monitorimin e IAP-ve, për ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve të Institucioneve Arsimore të Zakonshme për Aftësinë e Kufizuar:</p> <p>Strukturat janë të pamjaftueshme kanë nevojë për shërbime mbështetëse për realizimin e monitorimit sistematik të veprimtarisë së këtyre organizimave.</p> <p><b>DRAP Durrës</b> – s’ka</p> <p><b>DRAP Lezhë</b> – s’ka përgjigje</p> <p><b>DRAP Korçë</b> - 670 nxënës me aftësi të kufizuara kanë ndjekur shkollën në distancë sipas planit edukativ individual. Aktualisht nuk janë kryer monitorime apo inspektime të dedikuara për realizimin e mësimin on-line për fëmijët me aftësi të kufizuara. Strukturat e monitorimit dhe inspektimit janë sektori I monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP dhe sektori I inspektimit dhe vlerësimit të cilësisë në DRAP. Këto struktura funksionojnë për monitorimin dhe inspektimin e IAP në çdo aspekt të procesit mësimor.</p>																			
2	A disponon çdo IA e arsimit special si dhe e shkollave të zakonshme një regjistër të posaçëm, në të cilin identifikohen sipas diagnozave individuale për çdo nxënës me AK. Si bëhet dhe nga kush ndiqet monitorimi i tyre? Jepni të dhëna konkrete dhe shpjegimet përkatëse.	<p><b>DRAP Fier</b> - Bazuar në të dhënat e ZVAP-ve të varësise rezultoi se çdo IA disponon databaza me të dhënat e nxënësve me AK në të cilën përfshihet edhe diagnoza e tyre. Monitorimi ndiqet dhe realizohet nga KIA e mandej në nivel ZVAP-i nga KMD.</p> <p><b>DRAP Durrës</b> – s’ka</p> <p><b>DRAP Lezhë</b> - Po çdo IA ka disponon një dosje për nxënësit me AK ku ka të evidentuar nxënësit me AK me të dhënat dhe diagnozat përkatëse.</p>																			

NR.	NË LIDHJE ME PYETJET E PYETËSORIT: Legjenda	PËRGJIGJET E PYETËSORIT SIPAS DRAP <sup>-EVE</sup>			
		DRAP Fier	DRAP Durrës	DRAP Lezhë	DRAP Korçë
		<p>Monitorimi i tyre ndiqet nga drejtoria dhe punonjësi i shërbimit piko social, bashkërisht me mësuesin ndihmës dhe mësuesin e klasës.</p> <p>-Certifikatë personale e fëmijës</p> <p>-KMCAPO ose diagnoza nga komisioni mjekoligjor i fëmijës</p> <p><b>DRAP Korçë</b> - Në Institucionet Arsimore Parauniversitare nuk ka regjistra të veçantë për nxënësit me aftësi të kufizuara, ata figurojnë tek regjistri i klasës. Plani mësimor I përshtatur dhe plani edukativ individual janë dokumentacione të institucioneve arsimore shtesë të përshtatura për nevojat e nxënësve. Plani mësimor përshtatet sipas aftësive të nxënësit dhe plani edukativ individual përmban një tërësi drejtimesh ku mësuesi ndihmës duhet të përqendrohet për përparimin e nxënësve me aftësi ndryshe</p>			
<b>IV</b>	<b>MBI PLOTËSIMIN ME STAF</b>				
<b>1</b>	<p>Sa është numri mjekëve të cilët janë angazhuar pranë komisioneve Multidisiplinare në ZVA për periudhën 2019, 2020, 2021, 6 muajori i 2022?</p> <p>Keni patur raste ku mjekët nuk i përgjigjen thirrjes tuaj për t'u angazhuar në Komisionet Multidisiplinare?</p> <p><i>Nëse po, specifikoni në sa raste dhe arsyet e mos angazhimit të tyre.</i></p>	<p><b>DRAP Fier</b> - Bazuar në të dhënat e ZVAP-eve të varësisë rezultojnë se numri mjekëve të cilët janë angazhuar pranë komisioneve Multidisiplinare në ZVA për periudhën 2019, 2020, 2021, 6 muajori i 2022, deklarohet?:</p> <p>2019-2020: 15</p> <p>2020-2021: 13</p> <p>2021-2022: 12</p> <p>Arsyet e mos angazhimit të tyre nuk bëhen të ditura nga personeli mjekësor, por nuk i përgjigjen thirrjes për bashkëpunim.</p> <p><b>DRAP Durrës</b> - Shumica e ZVAP-ve kanë raportuar që kanë mungesë të mjekëve në komisionet Multidisiplinare. Nga të dhënat e mbledhura rezultojnë që gjatë gjithë periudhës 2019-2022, ZVAP Tiranë ka raportuar se mjeku i cili nuk është angazhuar në këto komisione, nuk ka dhënë një arsye.</p> <p><b>DRAP Lezhë</b> - 1 mjek.</p> <p>Nuk kemi patur raste</p> <p><b>DRAP Korçë</b> - Angazhimi I mjekëve në komisionet Multidisiplinare sipas ZVAP është si më poshtë; 2019 -11 mjekë, 2020 13 mjekë, 2021 – 13 mjekë</p>			
<b>2.</b>	<p>Sa është raporti mësues ndihmës/fëmijë me AK në rang ZVA për vitet objekt auditimi?</p> <p>Sa janë konkretisht nevojat reale të institucionit arsimor, për mësues ndihmës?</p>	<p><b>DRAP Fier</b> - Bazuar në të dhënat e ZVAP-eve të varësisë rezultojnë se numri raporti mësues ndihmës/fëmijë me AK për ZVAP Finiq-Dropull, Roskovec, Selenice, Përmet, Mallakastër, Vlorë për vitet objekt auditimi është 1 mësues ndihmës për 2 fëmijë me AK.</p> <p>Në ZVAP Lushnje raporti është 1 mësuese me 1 fëmijë.</p> <p>Në ZVAP Tepelenë raporti është 1 mësuese me 2,5 fëmijë.</p> <p>Në ZVAP Divjakë dhe Fier raporti është 1 mësuese me 3 ose 2 nxënës.</p> <p>Në ZVAP Sarandë raporti është 1 mësuese me 3 ose 4 fëmijë.</p> <p><b>DRAP Durrës</b> - Raporti afërsisht është 1 mësues ndihmës ka përgjithësisht 2- 3 fëmijë me AK. Nevojat reale të institucionit arsimor varen nga numri i fëmijëve me AK në atë institucion. Sipas përcaktimeve në udhëzim duhet 1 mësues për 2 nxënës të një klase.</p> <p><b>DRAP Lezhë</b> - Mesatarisht 1 mësues me 5 fëmijë. Momentalisht janë planifikuar 36 mësues ndihmës dhe me këtë mbulohet numri aktual i fëmijëve.por jemi akoma në proces vlerësimi sepse disa nga fëmijët nuk paraqesin dokumentacionin e plotë edhe pse kanë një diagnozë.Ndaj do të rishikohen serish nevojat.</p> <p><b>DRAP Korçë</b></p> <p>Mësues ndihmës të punësuar 2019 -190; 2020 – 209; 2021 -246</p> <p>Nevoja reale për mësuesi ndihmës 2019 – 211; 2020 -220; 2021-246</p>			
<b>3.</b>	A janë siguruar kushtet optimale të punës për shërbimin psiko-social?	<p><b>DRAP Fier</b> - Bazuar në të dhënat e ZVAP-eve të varësisë rezultojnë se nuk janë siguruar kushtet optimale për punën e shërbimit psiko-social.</p> <p><b>DRAP Durrës</b> - S'ka</p> <p><b>DRAP Lezhë</b> - Ka shumë mungesa në infrastrukturën e shërbimit psiko-social.(zyrë, kompjuter, printer. materiale kancelarie).</p>			

NR.	NË LIDHJE ME PYETJET E PYETËSORIT:	PËRGJIGJET E PYETËSORIT SIPAS DRAP <sup>-EVE</sup>																		
	Legjenda	DRAP Fier	DRAP Durrës	DRAP Lezhë	DRAP Korçë															
		DRAP Korçë – s`ka përgjigje																		
<b>V</b>	<b>MBI TRAJNIMET</b>																			
<b>1</b>	A janë kryer trajnime për mësuesit e arsimit të përgjithshëm, mbi arsimin gjithëpërfshirës? Sa trajnime janë kryer? Sa mësues kanë marrë pjesë në raport me numrin total të tyre sipas llojit të arsimit (fillor, i mesëm i ulët dhe i lartë)?	DRAP Fier - Bazuar në të dhënat e ZVAP-eve të varësisë rezultojn se nuk kanë informacion në lidhje me trajnimet e realizuara mbi arsimimin dhe gjithëpërfshirës.	DRAP Durrës - S`ka	DRAP Lezhë	DRAP Korçë															
<b>2</b>	A janë kryer trajnime të mësuesve ndihmës nga ASCAP dhe agjencitë trajnuese të licencuara nga Komisioni i Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit (KAPT). Vini në dispozicion një data bazë me evidencat përkatëse për vitet arsimore 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.	DRAP Fier - Bazuar në të dhënat e ZVAP-eve të varësisë rezultojn se nuk kanë informacion në lidhje me trajnimet e mësuesve ndihmës.	DRAP Durrës -S`ka	DRAP Lezhë	DRAP Korçë															
<b>VI.</b>	<b>PËR KOMISIONET MULTIDISCIPLINARE</b>																			
